

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 216, Tetor 2021
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Shenjtorja Nënë Tereza në Pult

Vendi ynë është kudo i bukur. Në pjesën më të madhe bukuritë e tij, janë të panjohura edhe nga vetë shqiptarët. Të përqendruar në zonat urbane, të zhytur në stresin e përditshmërisë, harrojmë se sa më shumë t'iu largohemi qendrave të qyteteve, aq më shumë do ta lumturonim shpirtin tonë. A nuk është kjo një pamje e mrekullueshme, teksa shoh Postribën, por që e ke mundësinë në këtë rreze kaq të gjatë vështrimi, të shohësh liqenin e Shkodrës? Destinacioni ynë do jetë në fshatin Bruçaj (Sume) të njësisë administrative Pult, e konkretisht në lagjen Dajca. Por për të shkuar atje do të kalojmë nga fshati Domen i Postribës. Edhe pse është dita e parë e shkollës, në oborr ka heshtje. Kilometrat e asfaltuar sapo kanë mbaruar dhe në vijim rruga do të bëhet e mundimshme. Janë tejet punëtorë banorët e fshatit Domen, ashtu si në të gjithë Postribën. I rrëmbejnë shkëmbit atë copë tokë dhe e bëjnë që të japë prodhime të mira. Kësaj here nuk do ndalemi në këtë fshat mik-pritës, por do të vijojmë të përshkojmë, atë rrugë aq të vështirë, të lënë totalisht në mëshirë të fatit, e që natyrshëm ka sjellë edhe izolimin e krahinës, pavarësisht se distanca nga Shkodra është tepër e vogël. Vetëm makinat e larta dhe të forta mund të hyjnë këtu. Rruga ekzistuese nuk ka qenë e asfaltuar ndonjëherë, edhe pse anash saj shih jo vetëm një peizazh të mrekullueshëm çka dëshmon se mund të kishte një turizëm të zhvilluar mirë. Nga ana tjetër edhe gjelbërimi i tejskajshëm dëshmon vlerat e shumta që ka krahina. E megjithatë përpjekja e shtetit shqiptar t'iu ardhur në ndihmë këtyre banorëve ka qenë zero.

2



SHKODRA I FESTON 90 VITET E FADIL KRAJËS

6

**"Teatri "Migjeni"
gjithmonë ka nevo-
jë për mendimin
dhe pendën tënde
"Mjeshtër i Madh"**

Dramaturgu i njohur dhe autori i shumë veprave, i cili shpreston të ketë vënë "një guralec në ngrehinën e teatrit shiptar", por ka bërë shumë më tepër, sot ka 91-vjetorin e datëlindjes. Gëzuar ditëlindjen e 91-të Mjeshtër! Të paçim sa më gjatë mes nesh! Këtë shkrim që mora përsipër ta shkruaj dhe ta botoj në gazetë, kushtuar një ngjarjeje të shënuar, datëlindjes së shkrimtarit dhe dramaturgut të madh Fadil Kraja, nuk e pata të lehtë, sepse natyrisht dëshirat për të folur për të në hapsirat ...



NJË JETË ME KANGË

"NJË JETË ME KANGË", titullohet libri i autorit Fran Kodra, i cili me datën 23 tetor 2021, u paraqit në bibliotekën "Marin Barleti", nën kujdesin e kryetarit të Shoqatës së Shkrimtareve-Shkodër, përkthyesit e redaktorit të librit, zotit Zija Vukaj, si dhe Drejtorit të bibliotekës, zoti Maxhid Cungu. Një organizim e drejtim i mirë, që e drejtonte gazetaria e njohur, Kozeta Bruçi, me kompetence të plotë. Morën pjesë mjaft personazhe të nderuar, të letrave në qytetin e Shkodrës, si: Presidenti i shtëpisë botuese "Fiorentina", përkthyesi e botuesi Meritan Spahia; Mjeshtri Madh, kompozitori Zef Çoba; Luigj Shyti, studiues e botues, Kryeredaktori i gazetës "Dukagjini"; këngëtar i mirënjohur, Zef Beka; kritiku Kadri Ujkaj; poetja Djana Çelepja Tabaku; administratori i Pultit, Tome Ndoka; studiuesi Kadri Fikaj; Mhill Pali, kryetari i shoqatës kulturore "Spani"; këngëtar Ndue Shytani; Poeti, historiani, publicisti e botuesi Prele Milani; poetja Lifee Hasa; botuesi Voc Deda; këngëtar i mësuesi në shkollën e Muzikës, Preke Mrisha; Rolanda Tuka-mozikologu; Aldo Nika, koreografi, këngëtar i vira Fierza dhe plote të tjerë, familjar e dashamirë të autorit të librit.

8

FESTA E GËSHTENJËS NË SHLLAK

Për të dytin vit radhazi njësisë administrative e Shllakut feston Ditën e Gështenjës. Lindja e kësaj feste, e cila festohet edhe në Reç të Malësisë së Madhe, në Krajë të Malit të Zi, apo dhe në Tropojë, u iniciua nga Mark Gjeka, i cili është shumë i lidhur me vendin e të parëve të tij dhe ka mbi një vit që po e promovon këtë zonë në rrjetet sociale. Kjo festë merr një vlerë tepër të veçantë këtë vit, pasi organizimi i saj është bërë nga vetë banorët, të cilët kane kontribuar sipas mundësive të tyre me bazë materiale, kryesisht produkte ushqimore, por edhe gjithë pajisjeve të tjera të nevojshme për t'iu krijuar pjesëmarrësve kushte të nevojshme për mbarëvajtjen e kësaj feste.

4

Një kontribut të vyer individual dhanë z. Mark Babani, z. Nikolin Deduk

Shenjtoria Nënë Tereza në Pult

Vendi ynë është kudo i bukur. Në pjesën më të madhe bukuritë e tij, janë të panjohura edhe nga vetë shqiptarët. Të përqendruar në zonat urbane, të zhytur në stresin e përditshmërisë, harrojmë se sa më shumë t'iu largohemi qendrave të qyteteve, aq më shumë do ta lumturonim shpirtin tonë.

A nuk është kjo një pamje e mrekulueshme, teksa sheh Postribën, por që e ke mundësinë në këtë rreze kaq të gjatë vështrimi, të shohësh liqenin e Shkodrës?

Destinacioni ynë do jetë në fshatin Bruçaj (Sume) të njësisë administrative Pult, e konkretisht në lagjen Dajca. Por për të shkuar atje do të kalojmë nga fshati Domen i Postribës. Edhe pse është dita e parë e shkollës, në oborr ka heshtje. Kilometrat e asfaltuar sapo kanë mbaruar dhe në vijim rruga do të bëhet e mundimshme. Janë tejet punëtorë banorët e fshatit Domen, ashtu si në të gjithë Postribën. I rrimbejnë shkëmbit atë copë tokë dhe e bëjnë që të japë prodhime të mira. Kësaj here nuk do ndalemi në këtë fshat mikpritës, por do të vijojmë të përshkojmë, atë rrugë aq të vështirë, të lënë totalisht në mëshirë të fatit, e që natyrshëm ka sjellë edhe izolimin e krahinës, pavarësisht se distanca nga Shkodra është tepër e vogël. Vetëm makinat e larta dhe të forta mund të hyjnë këtu. Rruga ekzistuese nuk ka qenë e asfaltuar ndonjëherë, edhe pse anash saj sheh jo vetëm një peizazh të mrekullueshëm çka dëshmon se mund të kishte një turizëm të zhvilluar mirë. Nga ana tjetër edhe gjelbërimi i tejskajshëm dëshmon vlerat e shumta që ka krahina. E megjithatë përpjekja e shtetit shqiptar për t'iu ardhur në ndihmë këtyre banorëve ka qenë zero.

Sa me lart që ngjitemi, aq më shumë i mbushim mushkëritë tona me ajër të pastër. Në fakt, sot e kemi ndërmarrë një udhëtim të tillë, për të sjellë një ngjarje me të vërtetë të madhe për këtë krahinë. Vendosi e një shtatoreje!

Ne kemi qenë edhe para dy viteve këtu, ku gjatë një veprimtarie, për promovimin e resurseve të Pultit, asistua edhe në ngritjen e lapidarit, kushtuar 10 dëshmorëve të atdheut, që u vranë nga terrori komunist më 27.9.1944. Fare pranë lapidarit ndodhet edhe fotografia e Shenjtores Nënë Terezës, pikërisht në vendin e quajtur Kroni i Thanës. Aty ndeshemi me miqtë e parë. I gjejmë duke u takuar me njëri-tjetrin. Një pjesë kanë kohë pa u parë. Pjesa më e madhe i kanë rrënjët pikërisht në Dajca, por mes tyre ka dhe mjaft të tjerë që i përkasin fshatrave përreth, pjesë e dy njësisë administrative Pultit dhe Postribës, që qëndrojnë sup në sup me njëra-tjetrën. Menjëherë ngjitemi në një nga pikat më të larta të vendit ku ndodhemi, në fortesa, dhe nuk ngopemi duke parë gjithë peizazhin e mahnitshëm që shtrihet para nesh, e cila përfshin gjithë kurorën e maleve, luginat e dy liqenit, atë të Shkodrës dhe të Vau Dejës. Në këtë lëndinë të vogël rrethuar nga lartësitë e Alpeve, nga organizatorët janë marrë të gjitha masat për mbarëva-



Monumenti e Shenjtores Nënë Tereza

jtjen e veprimtarisë. Asnjëherë më parë nuk ka pasur kaq shumë makina këtu. Me sa duket, arsyeja e ardhjes, është vlerësuar si tepër e rëndësishme nga këta miq të grumbulluar sot. Në pjesën më të madhe bisedat vërtiten rreth së kaluarës, atëherë kur këta burra që shihni sot ishin fëmijë apo të rinj, jetonin këtu, por në përpjekje për të pasur një jetë më të mirë migruan në qytete, aty ku gjetën punësimin dhe sigurojnë të ardhurat. Të gjithë sot këtu, i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së Tome Sahatçisë, i njohur në Shkodër si administrator i kompleksit të njohur "Dubai", i cili kësaj radhe, me dakordësinë e gjithë

Sahatçisë për realizimin e kësaj shtatoreje. Përgjatë dy muajve ai projektoi dhe realizoi një nga ëndrrat më të mëdha të jetës së tij, vendosjen e një shtatoreje të tillë në vendlindjen e tij. Ndodhemi në një fshat, ku përbërja e banorëve është si myslimanë ashtu edhe katolikë, por mund të merret si një model i harmonisë fetare. Mes atyre që e ndihmuan për sheshimin e vendit dhe vendosjen e shtatores ishte edhe Kasemi, banor i fshatit Domen.

Toma është një ndër pasardhësit e fisit Vocaj, i përmendur për zemërgjerësinë dhe kontribute në ndihmë të fshatarëve. Shtëpia e Prek Ndue Vocit, e përbërë di-



Administratori Tome Marku, për Pultin dhe Altin Shaba, për Postribën

banorëve, në shenjë nderimi për humanizmin e Nënë Terezës (Shenjtores Nënë Tereza), ka realizuar shtatoren e saj dhe po e vendos në pjesën më të lartë, me një fushëpamje të madhe, të pronës së të parëve të tij. Ndodhemi në fshatin Bruçaj (Sume), në vendin e quajtur Qafe Thanë.

Optimizmi i banorëve, edhe atyre mysliman, për rëndësinë që po merr vendi me vendosjen e shtatores së Nënë Terezës, është i madh. Nuk mund ta fshehim habinë që kemi teksa mësojmë për vullnetin e mirë dhe iniciativën e Tome

kur nga 7 vëllezër, sot numëron rreth 300 meshkuj në përbërje të saj. Vendosi e shtatores së Shenjtores së Nënë Terezës është një akt human, që Tome Sahatçia e bëri duke ndjekur zemrën e tij.

Të gjithë miqtë që i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së Tome Sahatçisë në inaugurimin e shtatores së Nënë Terezës, i afrohen pranë asaj, pasi një ceremoni e thjeshtë do shoqërojë një veprim të madh human. Prerja e shiritit të inaugurimit, do të bëhet në mënyrë simbolike nga dy përgjegjësit e njësisë administrative të

Pultit dhe Postribës, Tome Marku dhe Altin Shabaj, të cilët u përkasin besimeve të ndryshme, por që janë vëllezër mes tyre. Në fjalën e tyre ata e vunë theksin tek harmonia mes banorëve të dy besimeve, dakordësia e tyre në vendosjen e shtatores dhe mundësia e zgjimit të interesit pas pelegrinazheve që do të bëhen këtu, e që mund t'i hapnin dritën jeshile investimit për asfaltimin e 18 km rrugë automobilistike. Kurse vete iniciatori i kësaj veprimtarie, Tome Sahatçia mes të tjerave tha: "Zoti ma ka shndrit mendjen dhe familja ka qenë një mbështetje e madhe për mua!". Ai ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre dhe është shprehur i gatshëm t'i ndihmojë edhe në

situata të tjera të vështira, ashtu siç ka vepruar në vendosjen e rrjetit elektrik apo dhe ujit të pijshëm në fshatin e tij.

Pas vendosjes së një kurore pranë shtatores së Nënë Terezës, kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, në fjalën e tij të rastit, dënoi ashpër paragjykimet fetare duke e vënë theksin tek uniteti unë kombëtar, që duhet të na çojë përpara në përmirësimin e jetës në vend. Kurse biznesmeni Gjon Dukgilaj e vlerësoi vendosjen e shtatores si një fillim i mirë për zhvillimin e turizmit në krahinë, e cila ofron resurse të panumërta.

Në veprimtarinë e inaugurimit të shtatores së Nënë Terezës, edhe pse pjesëmarrësit ishin të shumtë, u vu re mungesa e përfaqësuesve nga Bashkia Shkodër, apo edhe e Misionarëve të Nënë Terezës.

Tome Sahatçia nuk i ka ndalur projektet e tij vetëm me vendosjen e shtatores. Ai mendon ta zgjerojë investimin, duke u dhuruar pelegrinazheve apo vizitorëve që vijnë këtu edhe ambiente të tjera funksionale për veprimtaritë e tyre në të ardhmen.

Me përfundimin e ceremonisë së inaugurimit të Shtatores së Nënë Terezës, nga organizatorët, përfaqësues të fisit Vocaj, ishte menduar shtrimi i një dreke me gati-met bio të zonës, për të treguar mirëpritjen dhe bujarinë ndaj atyre që morën mundimin për të ardhur deri këtu.

U frymëzuam nga dashuria e këtyre banorëve për vendlindjen e tyre, dhe atëherë kur mendohej se xhirimet kishin përfunduar, nuk e kishim imagjinuar se një surprizë mjaft e këndshme na priste. Një djalë i ri, i quajtur Flamur Elezi, këmbënguli që të na tregonte Kronin e Ftohtë si dhe disa lëndina aty pranë. Distanca nuk ishte e largët, por bukuritë ishin tepër të mëdha. Kureshtja jonë u bë e madhe, për më tepër dëshironim të fiksonim në këtë reportazh disa nga peizazhet e bukura të këtij vendi, edhe pse duhet pranuar që janë një pjesë fare e vogël e asaj që mund të të mahniste në të gjithë Pultin.

Flamuri besonte se një ditë, nëse rruga do të asfaltohej, turizmi në këtë vend

mund të merrte zhvillim të madh. Ngritja e bujtinave nuk do të vononte dhe rimëkëmbja e kullave do ishte e pashmangshme.

Të rinjtë depërtonin mes gjelbërimit dhe pamjeve mbresëlënëse që na shoqëronin. Ata banojnë kryesisht në qytetin e Shkodrës dhe në Vrakë të Malësisë së Madhe, por që në vogëli janë rritur me dashurinë për vendin e tyre. Zamira, ndryshe nga vajzat e tjera, është nuse në këtë vend, por e do njëlloj sikur të ishte bijë.

Jemi fare pranë vendit të quajtur Kroni i Ftohtë. Mësojmë se vendi rreth e rrotull është plot me kroje, çka e dëshmon edhe gjelbërimi i tejskajshëm. Uji i pastër e i ftohtë si kristali, herë pas here është një ilaç i mirë për çdo udhëtar që kalon këtej. Me fillimin e shirave uji i kronit shtohet. Kurse në dimër, të rinjtë shprehen se këtu peizazhi është mahnitës, me borën e bardhë që mbështjell gjithçka. Fare pranë dëgjohen zhurmat e çekiçëve. Po ndërtohet një shtëpi e re. Menduam që udhëtimin ta zgjasim edhe pak, pasi më tutje peizazhi pritej të ishte i pakrahasueshëm me asnjë vend tjetër sipas të rinjve. Mësojmë se vendi ku ndodhemi banorët i thonë “te kryqi”. Është shumë e vështirë të gjenden fjalët për ta përshkruar këtë peizazh, për të cilin sytë nuk arrijnë të ngopen. Është kënaqësi të mësosh se sa krenarë ndihen këta të rinjtë për vendin e tyre. Livadhet këtu majë Alpeve janë të mëdhaja, të sheshta e të bukura. Lënë shteg për zhvillimin e mjaft veprimtarive, mjafton që të ishte rruga e asfaltuar. Një copë herë mund të qëndrosh këtu dhe soditësh gjithë detajet që të ofron natyra. Asnjë piktor nuk do mund të përmbledhte gjithë jetën



Tome Sahatçia, duke përshëndetur të pranishmit



Ndue Sanaj, me Gjon Dukgilen, duke përshëndetur për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini” e parë nga maja e Alpeve në një telajo të vetme. Mësojmë se aty mes gjelbërimit të tejskajshëm gjendet lagja Gurra, ku dhe

ka të parët e saj edhe familja me të njëjtin emër. Frani thotë se mes dy përrënjeve që ndodhen poshtë, babai i tij ndërtoi mulli-

rin. Familja mbante rreth 40 krerë lopë, e pazakontë në kohën e kooperativave. Terreni është i vështirë, por njerëzit shumë punëtorë. Ky vend quhet Nën Shkallja, duke rënë nën Krue të Vizit, ose Çetat e Kalorit, një vend i rrezikshëm. Të gjitha këto vende u duhen treguar të rinjve, sepse ndryshe do harrohen dhe do të fshihen edhe nga kujtesa e popullatës.

Edhe pse vendet që përmendim të rinjtë janë të shumta, është e pamundur që brenda një dite t'i vizitojmë të gjitha. Prandaj ardhja në Pult kërkon një organizim më të madh dhe qëndrim disa ditë. Këto oborre qëndrojnë të mbushura me familjarë sidomos gjatë verës. Është në mendësinë e krahinës, që pavarësisht se jeta zhvillohet në qytet, të vijnë këtu të gjithë dhe kalojnë pushimet e verës.

Marrim rrugën e kthimit. Nga vendi ku u vendos shtatorja e Nënë Terezës, kemi udhëtuar vetëm 30 minuta. E dimë që vonesa jonë për tu kthyer tek vendi i veprimtarisë, nga ku do nisë dhe rruga e kthimit në Shkodër, i ka kaluar parashikimet, por të gjithë tregohen të mirëkuptueshem, pasi e duan të gjithë promovimin e krahinës.

Vështirimi i Nënë Terezës tashmë do të nisë nga Pulti e deri në Liqenin e Shkodrës. E çdo vizitor, që do të vijë pranë shtatorës do të lexojë gjithmonë këto fjalë mikpritëse: “Ardhja jote në këto male Shenjta Nënë Terezë, edhe ajrin e bën më të ëmbël për pelegrinët apo turistët e shumtë që do të vijnë!”.

Vetëm 18 km ju distancojnë nga bukuritë e Pultit. Ai gjithmonë do t'ju mirëpresë!

Përgatiti, Kozeta Bruçi,
gazetare Tv1 Channel,
Shkodër, më 3.10.21

Ne duhet të udhëhiqemi nga thëniet e Shenjtores Nënë Tereza, për t'u emancipuar si individë e shoqëri

- Fjala përshëndetëse, me rastin e inaugurimit të monumentit të Shenjtores Nene Tereza, e vendosur në qafe Thanë të fshatit Sumë -

Të nderuar të pranishëm!

E nderuar familja Vocaj!

I nderuar zoti Tome Sahatçia, organizatori i këtij inaugurimi!

Kënaqësi e veçantë, që ndodhem me ju, që në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” të përshëndes ju të pranishëm dhe familjen Vocaj, në këtë inaugurim të veçantë për nga personaliteti, që është shenjtërorja Nene Tereza, por dhe ku vendoset, aty ku fillojnë malet e Dukagjinit.

Unë nuk dua të foli për jetën e veprën e Shenjtores së Nene Terezës, por për diçka tjetër, që mendoj se koha na i kërkon me çdo kusht, në qofte se duam të ecim krahas me popujt e tjerë të zhvilluar, me popujt e tjerë të emancipuar.

Është e lehtë, të ngrijmë e vendosim buste, monumente apo memorialë, që dhe këto kane vlerën e tyre të padiskutueshme, por e rëndësishme është çfarë marrim apo mësojmë nga vepra e tyre, që të jene udhërrëfyese në ecjen tonë.

Shenjëtarja Nene Tereza ka një vepër të jashtëzakonshme, që ne duhet të udhëhiqemi në jetën tone, në jetën e bashkësisë sonë, në jetën e kombit tone.

Sa e madhe dhe sa duhet të udhëhiqemi

prej thënies së saj: “Jo të gjithë mund të bëjmë gjëra të mëdha. Por ne mund të bëjmë gjëra të vogla me shumë dashuri”. A duhet ne të mos merremi me gjoja me pune të mëdha dhe nuk bëjmë asgjë? Po!, Pra, duhet të fillojmë të punojmë pak e nga pak, me plote besim e dashuri, për të arritur te objektivi madhor? Patjetër që po.

Ne që duhet të ecim përpara, duhet të largohemi sa më pare nga mendësitë orientaliste, të cilat kryesisht ndalen te UNI e te PËRJASHTIMI, që do të thotë, është e drejte po e thashë UNË dhe përjashtimi deri në armik. Kjo mendësi orientaliste nuk na lejon të bashkohemi e ta pranojmë njeri-tjetrin siç jemi, prandaj thekson Shenjtorja Nene Tereza, “Nëse nuk kemi paqe, kjo është për shkak se kemi harruar që i përkasim njëri-tjetrit”. Dhe Tomas Xhefferson, ish Presidenti i SHBA dhe një nder themeluesit kryesor i kushtetutës Amerikane, thekson: “Unë kurrë nuk e kam marrë si shkak për t'u ndarë nga një mik dallimin e opinionit mbi politikën, fenë, apo filozofinë.”

Ne duhet të largohemi sa më pare nga mendësia “Ai e ka fajin”, çka do të thotë që ne asnjëherë nuk do të dimë se

kush jemi; nuk do të dimë se cila është përgjegjësia e ime. Pra, unë kush jam, cila është përgjegjësia e ime? Nëna thotë: “Nëse i gjykoni njerëzit, nuk do keni kohë t'i doni ata”.

Thëniet e Shenjtores Nënë Tereza për jetën janë lapidar, por kam veçuar një të tjetër prej tyre “Jeta është tepër e çmuar, mos e shkatërro”, që jo në pak raste e shkatërrimë, si i thonë popullorçe, “për një plesht djegim jorganin” dhe ne jo në pak raste e shkatërrimë jetën e tjetrit e jetën tone.

Jo në pak raste dëgjojmë dukagjinat, që theksojnë, se shteti e braktisi Dukagjinin. Po, është e vërtete, se shteti deri tani e ka braktisur Dukagjinin. Po, shtrohet një pyetje e thjeshtë: “Po, ne, pse e kemi braktisur Dukagjinin?!” Mësuesi dukagjinat thotë, se është braktisë mësimi i fëmijëve në Dukagjin, por ama vete e ka braktisur! E theksoj këtë mendësi, se ne së pari, duhet ti themi vetes: “Çfarë kam bërë e po bëj për Dukagjinin?!” Kur ti japësh përgjigje kësaj pyetje, të vendos veten në krye të punës, atëherë i lind e drejta të kërkoje nga të tjerët.

Të largohemi sa më pare nga ndjenja e paragjykimit, e cila jo në pak raste na ka

çuar në largimin nga njeri-tjetri, madje dhe duke shkatërruar atë dhe veten. Gëzoju për atë që bëhet dhe pastaj ulu me shokun apo me shoqen e analizoje dhe së bashku të nxjerrim mësim për të tjera organizime apo veprimtari, që të bëhen më mirë. Por e keqja fillon të lëshojë rrënje, kur njeri mendon se, është më i miri, se tjetri.

Mund të përgatitet e zhvillohet një simpozium i veçantë për këshillat e shenjtores Nënë Tereza, por kaq mendova të theksoj, se ne të gjithë kemi nevojë të emancipohemi, dhe të gjitha këshillat apo thëniet e Saj janë themeli i emancipimit të njeriut, i emancipimit të shoqërisë.

Familja Vocaj, për këtë nismë, për këtë realizim dhe vendosje, në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, ju përgëzojë! Shenjtorja Nënë Tereza, ju priftë në jetën tuaj, në punët tuaj! Por Ajo thekson: “Pas çdo arritjeje vjen nisja, pas çdo rezultati një sfidë e re!” Pra, nisma të tjera e të tjera do të marrim dhe sfida të tjera e të tjera do të përballojmë.

Ju faleminderit!

Ndue Sanaj,
Sumë, më 27 shtator 2021

FESTA E GËSHTENJËS NË SHLLAK

Për të dytin vit radhazi njësia administrative e Shllakut feston Ditën e Gështenjës. Lindja e kësaj feste, e cila festohet edhe në Reç të Malësisë së Madhe, në Krajë të Malit të Zi, apo dhe në Tropojë, u iniciua nga Mark Gjeka, i cili është shumë i lidhur me vendin e të parëve të tij dhe ka mbi një vit që po e promovon këtë zonë në rrjetet sociale. Kjo festë merr një vlerë tepër të veçantë këtë vit, pasi organizimi i saj është bërë nga vetë banorët, të cilët kanë kontribuar sipas mundësive të tyre me bazë materiale, kryesisht produkte ushqimore, por edhe gjithë pajisjeve të tjera të nevojshme për t'iu krijuar pjesëmarrësve kushte të nevojshme për mbarëvajtjen e kësaj feste.

Një kontribut të vyer individual dhanë z. Mark Babani, z. Nikolin Dedvukaj me ujin Alpin si dhe Nikolin Martin Shqau me grupin e punës të bar-restorant "San Francisco". Edhe pse festa ende nuk ka hyrë në projektet e Bashkisë së Vau Dejës, pjesë e së cilës është dhe Shllaku, ajo ka rritur autoritetin e saj edhe pse është ende në hapat e parë.

Shllaku e meriton një festë të tillë pasi në territorin e tij numërohen rreth 333 ha me gështenja të shtrira në një sipërfaqe prej 129.32 km katror në gjithë njësinë. Gështenja që gjendet në Shllak është shekullore, e mbirë në gjendje natyrale. Vetëm 10 ha janë të mbjella nga dora e njeriut, gjatë kohës së ish ndërmarrjes pyjore Shkodër, në kohën e monizmit, e cila gjendej në fshatin Kron i Madh e Vukjakaj Gegaj. Gështenja ka një dru shumë të fortë për ndërtim, i cili përballon temperaturat e ulëta dhe lagështirën. Mes viteve 1990-1995 ka pasur dëmtime të konsiderueshme, prerje pa kriter.

Shllaku, pa përmendur pjesën e Mazrekut, ka plantacione natyrore të përqendruara kryesisht në: Barcollë, Vasiaj, Vilëz, Vukaj, Kroni i Madh e Vukjakaj. Gështenja prej shekuj është e ndarë në kashnjete, ku secila familje ka kashnjetin e saj. Me ndarjen e familjeve është ndarë edhe pjesa sipas kurorave. Asnjë familje pa leje nuk hyn në pjesën e tjetrit. Ky rregull ka qenë i sanksionuar në të drejtën tradicionale.

Gështenja është quajtur frutë i Perëndisë, ose pema e bekuar. Ky frutë përdoret jo vetëm për pjekje apo zierje, por edhe për industrinë ushqimore. Ajo shtohet me kokërr dhe fidanë dhe shquhet për dobitë në shëndet si: ul kolesterolin, ndihmon në mirëfunksionimin e zorrëve, forcon kockat dhe dhëmbët, është anti-depresive, forcon flokët, qetëson sistemin nervor, ndihmon në prodhimin e qelizave të kuqe të gjakut, ndikon në rritjen fizike të fëmijëve, janë shumë të mira për atletët, e të tjera.

Festa e Gështenjës në Shllak, u organizua e zhvillua në Kodër-Ukbbibaj, në lartësinë ku është kisha e Shna Prendes e fshatit Ukbbibaj, me Dom Charbel Bachour; shkolla 9 vjeçare, me drejtor shkollë Kin Kola dhe Qendra shëndetësore e fshatit, me infermiere Shaqe Ndoja. Shkolla, qendra shëndetësore e



gjithçka për rreth vendit të festimit ishte një model.

Një poezi e një nxënësi të klasës VI, Besmir Mali

JAM SHQIPTAR

Po çfarë je o djalë i mbarë?
 Besa-besë unë jam shqiptarë
 Se Shqipëria më tha një fjalë
 Më ke nanë e të kam djalë
 Mos harro se je shqiptar
 Mos harro se të kam birë
 Të ka rritë nëna zog të lirë
 Po të më lidhin me vargue
 Unë e këpus se kam lind drague
 Vetën time se koris
 Ja kështu jam si fis
 Të bëhem rob kurrë s' duroj
 Do të marre pushkën e do të luftoj.



Në këtë feste, përveç gatimeve me produktet bio të fshatit apo të krahinës, kishte edhe programin artistik, të cilit i paraprinë fjalët e rastit.

Ne këtë feste morën pjesë shumë banorë dhe miq. Ne mes tyre ishin përfaqësues të komisionit Drejtësi e Paqe, me Luigj Milen, sekretarin e këtij komisioni; përfaqësues të shoqatës së Operatorëve Turistik, me kryetarin Rexhep Kapsi; të shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me kryetarin Ndue Sanaj; të Bar-Restorant "TRADITA", me pronarin e tij, Gjon Dukgijl; të Shoqatës Atdhetare "Malësia", me kryetarin Ilmi Kurti; TV Klan, me gazetaren e mirënjohur Alma Çupi; nuk mungoi as pjesëmarrja e operatoreve turistike, kompanive të sigurimit, bizneseve në Shkodër, shoqatave të ndryshme, e të tjerë.

Një e veçantë ishte mbërritja në festë e një grupi të rinjsh me biçikleta, të cilët tashme janë profesionistë të udhëtimeve me një mjet të tillë në terrene malore.

Festa e Shllakut pritet të kthehet në një traditë. Fakti që nga 170 pjesëmarrës që kishte vitin e kaluar, dhe 300 këtë vit, tregon se ajo po merr jehonë dhe pritet që me mbështetjen akoma më të madhe edhe nga strukturat vendore, të rrisë zhvillimin e turizmit në zonë, e më kryesorja të tërheqë vëmendjen ndaj gështenjave, një pjesë e të cilave janë lënë në mëshirë të fatit.

Programi u drejtua nga gazetarja Kozeta Bruçi, e cila rikthehej në këtë zonë pas 16 vitesh nga realizimi i reportazhit të parë.

I pari që bëri dhe hapjen zyrtare ishte z. Miran Pali, banor i krahinës, njëherësh edhe njëri nga organizatorët. Ai vuri theksin tek dëshira dhe vullneti i banorëve për të kontribuar dhe mbështetur festën. Përgjegjësi i Njësisë Administrative Shllak, Kristjan Ndoja evidentoi faktin se vendi nuk është braktisur dhe çdo kullë qëndron e hapur, prandaj kjo ndikoi edhe në dhënien jetë të kësaj feste.

Z. Rexhep Kapsi, kryetar i Shoqatës së Operatorëve Turistikë mes të tjerave shtroi rëndësinë e vlerës së festave të tilla, të cilat tërheqin vëmendjen e vizitorëve, por që do ishte mirë të kishte ndikim edhe tek shteti shqiptar në investimin për asfaltimin e rrugës.


Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj vlerësoi këtë traditë të re, e cila shoqërohet edhe me traditat dhe mikpritjen e krahinës, duke vendosur lidhjet mes së kaluarës dhe së tashmes.

Më tej festa vijoi me një program artistik, ku interpretuan mjaft mirë këngëtarët nga Shllaku: Mark Vata, Viola Shqau, Agustin Pllumaj, Niko Mhilli, shoqëruar nga instrumentistët Sokol Gjeka, Lazer Tavosja, Kole Leka, e të tjerë.

Rritja e prodhimit, ndalja e sëmundjeve infektive, krijimi i një industrie për përpunimin e tyre, do shtonte interesin e banorëve që të mos e braktisin zonën, por ta sigurojnë jetesën e tyre pikërisht në vendlindje.

Përgatiti: Kozeta Bruçi,
 gazetare, Shkodër, më 25.10.2021

Shenja me element të varreve të vjetra në kodër të Ukbibajve



SHKODRA I FESTON 90 VITET E FADIL KRAJËS

“Teatri “Migjeni” gjithmonë ka nevojë për mendimin dhe pendën tënde “Mjeshtër i Madh”

Dramaturgu i njohur dhe autori i shumë veprave, i cili shpreson të ketë vënë “një guralec në ngrehinën e teatrit shiptar”, por ka bërë shumë më tepër, sot ka 91-vjetorin e datëlindjes. Gëzuar ditëlindjen e 91-të Mjeshtër! Të paçim sa më gjatë mes nesh!

Këtë shkrim që mora përsipër ta shkruaj dhe ta botoj në gazetë, kushtuar një ngjarjeje të shënuar, datëlindjes së shkrimtarit dhe dramaturgut të madh Fadil Kraja, nuk e pata të lehtë, sepse natyrisht dëshirat për të folur për të në hapsirat që lejon gazeta nuk mjaftojnë.

Të flasësh për Fadil Krajen, për këtë profesor në kuptimin e vërtetë të fjalës, për këtë krijues dhe erudit të shquar nuk është e lehtë.

I lindur në Shkodër 91 vite më parë (si i thonë në “një fjalë goje”) ky talent i ardhshëm u përkund në djepin e një qyteti siç është Shkodra, e cila në këtë kohë nga marrdhëniet që kishte me Europen, ishte edhe vetë një qytet që kishte përqafuar përparimin.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk është biografia e këtij dramaturgu të shquar, pasi për të është shkruar shumë, por në këtë shkrim unë marrë guximin të bëj një krahasim të madh, për të cilin edhe lexuesit mendoj se duhet të jenë dakort.

Shekspiri i famshëm shkëlqeu kur krijoi dhe u bë i pavdekshëm, sepse njohu dramën e mëdha të kohës që jetoi dhe sepse arriti që këto drama t’ia trashëgojë njerëzimit si një pasuri për të cilën edhe kësaj dite ndjehet krenar.

I tillë është për ne Fadil Kraja, “Shekspiri” i Shkodrës dhe i Shqipërisë. I tillë është për ne ky dramaturg i madh i përmasave jo vetëm shqiptare, por edhe më gjërë, ballkanike po e po.

Shekspiri është gjigandi i letrave të dramaturgjisë botërore, Fadili është gjigandi i letrave të dramaturgjisë shqiptare.

Po shkruaj kështu, sepse ky krahasim qëndron. Në fund të viteve ‘60, kur teatrit po i mungonte krijimtaria e penave shqiptare, erdhi në skenë pena e famshme e Fadil Krajës.

Ai erdhi në skenën e Teatrit “Migjeni” me të parën kryevepër të tij “Fisheku në pajë”, një dramë që suksesin e korri, jo vetëm për tematikën që tajtonte, por edhe për aftësinë e madhe të autorit, i cili kishte vite që akumulonte ngacmimet e një intelektualit të ri për t’i shfaqur me talentin e tij para një publiku që do t’i mirëpriste një ditë, do t’i miratonte dhe do t’i duartrokiste.

Në lidhje me këtë ka një rastësi shumë interesante, shoqëria shqiptare po përpiquej të emancipohej dhe misionin e parë për këtë gjithmonë e kanë artistët. Një ndër tribunat e këtij emancipimi qe edhe skena e teatrit të Shkodrës, që u bë tribunë, ku mendimin e këtij shkrimtari të madh e transmetuan për dhjetra netë me radhë më të zotët e fjalës, aktorët e mrekullueshëm të këtij teatri.

E pena e këtij “Shekspiri” shkodran nuk pushoi kurrë së shkruari. Ai solli në këtë

tempull pasqyrimin e historisë shqiptare, ai solli në këtë tempull, realitetin e jetës së qytetit të tij të dashur, të Malësisë dhe gjithë trojeve shqiptare, ai solli në këtë tempull, humorin e përditshëm, traditën e



bukur, Shkodrën e tij.

Ai solli në këtë tempull, dramën e mëdha të kombit: “Gjaku i Arbrit” dhe “Baca i Gjetajve”, duke u bërë kështu përçuesi i mesazheve historike që as vetë sistemet shtetërore me të gjithë mekanizmat e tyre nuk arritën kurrë t’i transmetojnë.

Dramat e fuqishme të Fadil Krajës kanë përlotur masa të gjëra njerëzish, kanë ngrohur zemrat e mijëra shqiptarëve, por edhe kanë përbetuar mijëra zemra të tjera në trojet shqiptare, që një ditë mesazhet



e dramave të tij të jenë pjesë e dëshmisë historike të një kombi.

Të gjitha këto sot janë realitet dhe në këtë realitet, një kontribut të shquar ka shkodrani ynë i nderuar, mësuesi i brezave

të tërë, poeti, shkrimtari dhe dramaturgu, “Shekspiri” Shqiptar, Fadil Kraja.

Kam shkruar diku që Fadil Kraja nuk ka një studio të mirëfilltë, një zyrë, një sallon pritje, por ka një tavolinë në një

ar sipas metodës së realizmit socialist, ariti të adaptohej e të shpalesë vlera të reja krijuese pa kufizime metodash, të trajtojë tematika të ditës me guximin e krijuesit elitari, duke dhënë kontribut në emancipimin e shoqërisë sonë.

Por, si çdo krijues, edhe ai ka relievin e vlerave të tij. Për mua si krijues e jo vetëm, ai ka arritur maja në fushën e dramaturgjisë aq sa, qofsha i pagabuar kësaj here të pohoj se nuk mund të flasësh për dramaturgjinë shqiptare pa folur për Fadil Krajën, ku ai është një nga gurët e themelit të saj. E kam një bindje se të jesh gur themeli në letërsi nuk është pak. Sepse muret edhe mund të lozin nga tërmetet e kohës, por themelet mbeten.

Ai që solli kujtime për një periudhë të gjatë bashkëpunimi, ishte ish drejtori i Teatrit “Migjeni”, Isa Alibali, i cili solli para të pranishmëve atë kohë të artë, kur trupa e Teatrit “Migjeni” për netë me radhë shfaqte dramën e Fadil Krajës, kur bashkëpunimi i këtij dramaturgu me regjisorin e madh Serafin Fanko, me trupën e teatrit të Shkodrës bënë epokë me kryeveprat e dramaturgjisë “Fisheku në pajë”, “Gjaku i Arbrit”, “Baca i Gjetajve”, “Çështja e Blertës”, “Sinjalet e natës”, “Shpartalimi”, “Njerëz të ditëve tona”, “Çështje familjare”, “Luani i shtëpisë”, “Skenderbeu”... e sa e sa vepra të tjera.

Drama “Fisheku në pajë” mbanë një rekord shfaqesh, mbi 500 herë dhe teatri popullor i Gjakovës në vitin ‘74, filloi punën me këtë dramë të vënë në skenë nga regjisorin i mirënjohur Muharrem Qena. Në viti 2000 kur Kosova digjej flakë, në këtë teatër u shfaq drama “Dasma e trojeve tona”.

Teatri i Strugës në vitin 2004 nisi shfaqjen e parë me dramën “Mos ma shkim hisen e diellit”, ndërsa teatri i Tuzit nisi punën me dramën “Tronditja”. Në Michigan një grup teatrosht nisi punën me dramën “Jorgani”.

Fjala e tij gjithmonë e zgjedhur, e ëmbël dhe pasionante, ka qenë qershia mbi tortë. Unë po veçoj njërin prej tyre: “Shkodra i ka dhënë shumë ndër vite kulturës dhe artit kombëtar. “Në qoftëse në Shkodër në themelet e kësaj kështjelle të madhe të kulturës e të artit me të cilën krenohet Shqipëria, kam vënë edhe unë një guralec, do të jem shumë i lumtur”.

Ashtu siç e ka dhunti, ai shpesh herë ka recituar një poezi të Hygoit “Kjo Është Jeta”: “Jeta është një melodi, fillon me nina nana, mbaron me liturgji. Jeta është një fat, një vrapim simbol. Starti është djepi, finishi arkivol. Dhe gjithë njerëzit e botës bërtasin që këtë vrapim sa më tepër ta zgjasin. Gjithë njerëzit një ditë do vdesin, ndoshta edhe unë”.

I urojmë dramaturgut të madh Fadil Kraja shëndet, por edhe jetë të gjatë me penën e tij krijuese dhe vepra sa më të vyera në shërbim të kombit e veçanërisht të rinisë shqiptare.

Nga Ramazan ÇEKA,
tetor 2021

DITA E PLISIT: PORTRETI I POPULLIT TONË, PROFILI I TIJ ETNIK, SHPIRTËTOR E MATERIAL

- Mbresa e përsiatje rreth manifestimit të tetë DITA E PLISIT, që u mbajt në Prugovc të Prishtinës -



Përgatiti Prend Buzhala,
Prugovc, në komunën Prishtinë,
14 tetor 2021

Sot në Prugovc të komunës së Prishtinës, ku u mbajt manifestimi DITA E PLISIT, ishte një ditë mbresëlënëse tetori për shumëçka: paksa një çlirim me masë nga shtrëngesat e pandemisë, takim miqsh, atmosferë festive me plisa të bardhë e me rroba kombëtare burrash e grash, këngë folklorike nga rapsodët, rrëfime anekdotash, lexime kumtesash, orë letrare, drekë e pasur me ushqime tradicionale popullore... një etnografi përplot emocione. Një ambient etnografik, tipik etnik, shqiptar, një mikpritje proverbiale e familjes Berisha dhe e Shoqatës së Grave Fermere "ALBA" drejtuar nga znj. Remzije Berisha. Është kujtesa jonë, e thadruar në memorien e kombit. Në këtë ambient rreth e rreth, janë vend punishtet e Shoqatës së Grave Fermere "Alba" dhe ekspozita me veshje kombëtare, më tutje tryezat e gjata me ushqimet tradicionale e të shumëllojshme popullore.

Përhëndesin miqtë nga Tirana (Agron Gjedia), nga Presheva e Tetova, Remzije Berisha në emër të grave fermere "Alba", falënderojnë edhe familjarë e individë që morën mirënjohje (kryesisht edhe për njerëz që vdiqën dy viteve të fundit e që kanë qenë pjesë e këtij manifestimi me kontribute të shumta). Përhëndetjet vijnë edhe në emër të MKRS.

Fillimisht jehon një këngë maje krahu nga rapsodi Nazmi Hajdari me moderimin e ideatorin e këtij manifestimi, Ismet Krasniqi Lala që jep një historik të shkurtër për manifestimin, vendet, kullat e ambientet e deritashme, për tetë vite rresht e me disa faza zhvillimesh brenda një viti.

1.

Nuk thuhet më kot se manifestimet e tilla janë portreti i një populli, profili i tij shpirtëror e material. Janë tradita, besime, mënyra jetese, mënyra këndimi apo të veshjes, mënyra të bërjes së ushqimeve.



Agron Isa Gjedia organizator Festa e Plisit të Bardhë që mbahet në Dajti - Tiranë, prof. Dr. Shefki Selami organizator "Dita e Plisit" në Tetovë, prof. Xhemaledin Salihu veprimtar nga Presheva dhe ka inicium organizimin "Dita e Plisit" në Preshevë

Pjesë e këtij portreti etnik janë edhe rrëfimet personale apo familjare, siç kishte edhe sot për Familjen Berisha, një zonjë që rrëfeu për sakrificën e brezave për lirinë e Kosovës. Ajo kishte ardhur nga SHBA, enkas për këtë manifestim, duke sjellë mallin, dashurinë për lirinë e Kosovës dhe nderimin për flijimet kombëtare për kohët e sotme. Janë njerëzit që e ndiejnë këtë lidhje gjaku e farefisnie që i zgjojnë manifestimet e tilla. Ndodh kështu, kur e ruajmë të pa shprishur identitetin tonë, të qenët vetvetja. Në takimet e tilla, zbulohet shumëçka që nuk ka qenë ende krejtësisht publike, qoftë edhe përmes kumtesave të Xhemaledin Salihut nga Presheva me titull "Presheva dhe plisi i bardhë nëpër kohë" dhe autorit të këtyre rreshtave, "Kultura e dëgjimit në traditën shqiptare".

Një ambient etnografik e etnik, i bërë

me shumë zemër, me dritën e re që sjell në kapitujt mahnitës të kohës sonë, - siç do të shprehej një personalitet i dijeve antropologjike. Është historia jonë e ndërjegjegjes, është korrespondenca e kohëve me njëra-tjetrën: që marrin e japin. Aty qëndrojnë burra e femra të shtëpisë Berisha, zonja e kësaj shtëpie Remzije Berisha me djemtë që qëndronin vetëm në këmbë për të qenë në shërbim e gatishmëri për gjithçka që duhej; ishin gratë e shoqatës, me veshjet kombëtare... është zonjë e një shtëpie me tradita patriotike, që luajti edhe rolin e babës së fëmijëve, i cili iu vdiq kur ata ishin të vegjël.

megjithatë, e duan një pjesë të saj. Mjaf-ton t'i ballafaqojmë dy fakte: paragjykimet ndaj gruas (për të mos qenë e lirë për të zgjedhur, dikur, njeriun që e dashuron), e që ishte pengesë e paragjykimeve patriarkale; dhe solidarësia popullore për ta ndihmuar njeriun në vështirësi, mikpritja, besa e vlerat tjera etnike e që janë frymëzim i përhershëm njerëzor, moral e nacional. Në këtë përplasje kohësh, do të vllente thënia e historianit amerikan, kritikut shoqëror dhe intelektualit Arthur M. Schlesinger: "Shkenca dhe teknologjia revolucionarizojnë jetën tonë, por kujtesa, tradita dhe miti përcaktojnë përgjigjen tonë."

Ky ambient me tablonë e tillë kulturore, me simbolikë të shumëfishtë etno-kulturore, me mbizotërimin e Plisit të Bardhë, që e bartnin burra, gra, të rinj e të reja, ishte ajo që quhet traditë e lavdishme, një realitet e ngjarje me rëndësi të veçantë. Një vizion për krenarinë e virtyteve të traditës. Një krenari e ligjshme edhe për autoktoninë e lashtësinë e qenies sonë në këto troje. Kënga e rapsodëve Kryeziu, Bytyçi, apo e lahutarit Nazmi Hajdari - një frymëzim kombëtar për lavditë tona historike; anekdota e fjala e urtë e Sali Zogianit, këtij qëmtuesi të zellshëm të folklorit tonë, me rrëfime magjepsëse e tejet joshëse - një traditë e mençurisë sonë që depërton përtej secilës kohë. I bashkëngjitet edhe Muzafer Osmani, po ashtu një mbledhës i zellshëm anekdotash.

Në fund u lexuan poezi nga disa krijues, kryesisht me tematikë plisin e bardhë. Përmbyllja u bë me shijimin e ushqimeve e me një foto të përbashkët.

Janë manifestime të praktikave moderne, e ku rrënjosja e traditës na e përcjell mesazhin universal, se secili popull i ka rrënjët e tilla dhe nga to nuk heq dorë.

Në pak orë shpaloset një copëz e pa-fund historie shpirtërore e materiale.



NJË JETË ME KANGË

“NJË JETË ME KANGË”, titullohet libri i autorit Fran Kodra, i cili me datën 23 tetor 2021, u paraqit në bibliotekën “Marin Barleti”, nën kujdesin e kryetarit të Shoqatës së Shkrimtareve-Shkodër, përkthyesit e redaktorit të librit, zotit Zija Vukaj, si dhe Drejtorit të bibliotekës, zoti Maxhid Cungu.

Një organizim e drejtim i mirë, që e drejtonte gazetaria e njohur, Kozeta Bruçi, me kompetence të plotë.

Morën pjesë mjaft personazhe të nderuar, të letrave në qytetin e Shkodrës, si: Presidenti i shtëpisë botuese “Fiorentina”, përkthyesi e botuesi Meritan Spahia; Mjeshtri Madh, kompozitori Zef Çoba; Luigj Shyti, studiues e botues, Kryeredaktori i gazetës “Dukagjini”; këngëtar i mirënjohur, Zef Beka; kritiku Kadri Ujkaj; poetja Djana Çelepia Tabaku; administratori i Pultit, Tome Ndoka; studiuesi Kadri Fikaj; Mhill Pali, kryetari i shoqatës kulturore “Spani”; këngëtar i Ndue Shytani; Poeti, historiani, publicisti e botuesi Prele Milani; poetja Lifée Hasa; botuesi Voc Deda; këngëtar i mësuesi në shkollën e Muzikës, Preke Mrisha; Rolanda Tuka-mozikologu; Aldo Nika, koreografi, këngëtarja Elvira Fierza dhe plote të tjerë, familjar e dashamirë të autorit të librit.

Dhanë opinione Zija Vukaj, Ndue Sanaj, Mhill Pali, Voc Deda, Preke Mrisha, Kadri Fikaj, Kadri Ujkaj, Aldo Nika, Rolanda Tuka, Elvira Fierza e

Mjeshtri i Madh, Zef Çoba, theksoi: “... Fran Kodra përfaqëson në fushën e trashëgimisë folklorike një nga modelet me vera të veçanta si mbartës i pasionuar, njohës, hulumtues e studiues. Me karrierën, debutimin dhe aktivitetin e tij të suksesshëm artistik në skenat më të njohura të vendit si dhe jashtë vendit, ka merituar respektin e publikut, të opinionit artdashës dhe të specialisteve si instrumentist virtuoz, rapsod, këngëtar dhe krijues i talentuar. Ai është protagonist shumë i njohur dhe gëzon një reputacion jo vetëm në trevën e Dukagjinit nga e ka origjinën, por edhe në mjediset artistike ku lëvrohet rregullisht jeta artistike folklorike, në Shkodër e më gjere.”


Rober Prenushi, thekson: “... Nga fidan u ba pemë, me frute të bukura e me rrajë të thella, një eksplorues dhe lavruer i apasionuar i pasqyrimin e lavrimin të vlerave tradicionale të trevës së tij; instrumentist shumë i talentuem, kantautor, drejtues dhe organizator. Ansambli “Treva” i krijuem prej tij, me atë repertor kaq të pasun, sot njihet në të gjitha vatrat shqiptare si një krenari e Dukagjinit, Veriut e krejt Shkodrës. ... sot, kur disa, me dashje o pa dashje, me shtymje apo me insiativen e vet, po degradojnë kangen shqiptare, krijimtaria e grupi i Fran Kodrës asht dhe një qëndrim i qartë patriotik për rrejtjen e lavrimin e folklorit e artit popullor ...”

Në fund e mbylli këtë ceremoni, autori i librit, Fran Kodra, i cili falënderoi pjesëmarrësit për kohën e çmuar, që planifikuan për ta nderuar dhe i ftoj në një koktej.

Fjala e plotë e redaktorit të librit, zotit Zija Vukaj

Të nderuar të pranishem, kjo përmbledhje e vëllimshme këngësh përbën një thesar të vërtetë në kulturën tonë folklorike. Me larminë e saj epiko- lirike kthehet në

një stacion të vyer nga ku gjenerojnë dhe buçasin jonet e traditës sonë burimore të këngëve veriore, duke na kujtuar, herë bëmat kreshnike të eposit tonë, që ushtojnë si gjamët e motit, herë idilet dashurore dhe eklogat pastorale të mbushura



me imazhe lëndinash të gjelbra, stanesh të bukura, këngësh të zogjve e gurrash të kristalta; gjithçka nën harmonië e tingujve të lahutës, çiftelisë, fyellit e zumares. Duke udhëtuar në rapsoditë e freskëta të autorit Fran Kodra, tashmë me shumë emër në fushën e vet të krijimtarisë, përjetova një ndjesi të ngjashme me efektin e flladit të bjeshkëve. Përveç lirizmit të hollë dhe hipërndjeshmërisë së një bjeshkëtarit të lindur e rritur si një krijesë natyrale alpeshe, kënaqësinë ma dha edhe frymëzimi i sinqertë poetik dhe përdorimi elegant i gjuhës. Sipas motiveve dhe tematikave, rapsoditë e këtij vëllimi mund të grupohen në tri lloje. Këngë epike, këngë lirike dhe këngë me motive shoqërore.

Grupi i parë përbëhet pothuajse i tëri nga këngë të epikës historike. Gjithçka është kompozuar mbi motive ngjarjesh dhe profile heronjsh, të cilët janë personazhe të spikatura, që kanë mbetur të stampuara në kujtesën e brezave për akte të rralla dhe shembuj të lartë guximi. Vargjet e këtyre rapsodive janë shkruar me ndjenjë të lartë veneracioni dhe tonesh madhështore. Teatri epik i këtyre këngëve me tingëllime himnizuese, është treva veriore e Shqipërisë, kryesisht krahina e Dukagjinit. Janë këngë që kanë linja të qarta narracioni dhe finale mbresëlënëse. Shumë prej këngëve të këtij cikli janë kushtime të frymëzuara nga vise e kësaj treve. Në këto kushtime për vise si Pultin, Shalën, Shoshin, Shllakun, por edhe Kelmendin, Hotin, Shkrelin etj., autori ka ndërkaq edhe imazhe heronjsh dhe grimca heroizmi. Pavarësisht se këto krijime janë të ngjizura dhe të destinuara për tekste këngësh, produkt i një autori real që quhet Fran Kodra, të jep përshtypjen e rapsodive që vijnë nga lashtësia, rapsodi që ngajnë sikur i ka krijuar gjenia e anonimatit popullor, gdhendur e latuar prore prej mjeshtërisë së shumë mendjeve. Të mbyllura në një rreth preciz të një përsosjeje estetike, shumë prej tyre tashmë kanë zënë vend dhe janë bërë të njohura për të gjithë. Përveç funksionit estetik, në këngët e ciklit epik të këtij vëllimi, është më i pranishëm se në pjesët e tjera funksioni i frymëzimit patriotik, i lartësimit të historisë së kombit

dhe i dashurisë për vendlindjen.

Në grupin e këngëve lirike vendin kryesor e zënë lirikat e dashurisë. Shumë krijime të këtij cikli shquhen jo vetëm si tekste këngësh, por edhe si poezi të një frymëzimi të rrallë, që mund të qëndrojnë në çdo vëllim poetik. Edhe këtu spikat arketipi i vendlindjes me veçoritë dhe variacionet e peizazheve idilike të bjeshkëve, të vrrinit, të tufave të deleve, të barinjve e të bareshave që thurin ëndrrat e tyre rinore ushqyer nga ndjenjat dhe parandjenjat e dashurisë, që shpesh mbeten si dekore mahnitëse të një realiteti virtual. Është për t'u theksuar delikatesa që përshkon këto motive. Kjo duket edhe në portretizimin e personazheve, edhe në paraqitjen e hijshme të dialogjeve, edhe në gjithë

fabuleskun e një lirizmi të hollë, brenda caqeve të një etike fisnike të ardhur nga shekujt, që shpeshherë të shpien te gjurmët e tanushave të eposit. Këtu autori Kodra ka shkarkuar më shumë se kudo edhe figuracionin dhe ndërtimin e imazheve. Kështu kemi:

Dola i herë nga bjeshka / Dola bash për qeft / Kur dola te kroni / Gjej bardhat rrjesht / Me grushtat e dorës / Njana m'ka dhanë ujë / Cila asht ma e bukura / Me ju than s'po muj.

Ka gjithashtu në shumë raste edhe segmente humorit që harmonizohen bukur me narrativën e thjeshtë të tekstit.

Në lirikat shoqërore dallojmë disa

motive, por më i dukshëm del motivi i kurbetit si shkak dhe pasojë realitetesh të trishta. Gjithashtu autori ka vendosur brenda këtij cikli dukuritë e tjera të kohës, si tjetërsimin e individit nën pushtetin e lakmisë, boshatisjen e fshatrave dhe mosruajtjen e traditave, braktisjen e vlerave kulturore dhe identitare etj. Edhe këtu autori përdor ironinë dhe sarkazmën si mjete të efektshme letrare. Këngët janë krijuar, shkruar dhe kënduar në dialekt, madje në nëndialektin e zonës së Dukagjinit. Kjo dallohet nga pasuria idiomatike karakteristike e kësaj të folure si dhe dukuritë e tjera gjuhësore, që i japin vargut verb plot kolorit e ngjeshje semantiko-morfologjike. Duhet vënë në dukje edhe aftësia intuitive e autorit në kompozimet e

tij poetike si tekste këngësh. I njohur me traditën popullore të kësaj fushe Frani ka ndërtuar jo vetëm strofa me numër të ndryshëm vargjesh dhe vargje me numër të ndryshëm rrokjesh, ku më i shpeshti është trokaiku popullor, por edhe refrene të bukura me përthyerje vargjesh e numër të ndryshëm rrokjesh. Rimat janë të pasura dhe muzikaliteti i vargut është i pranishëm kudo. Edhe mënyrat e interpretimit janë të shumëllojshme. Ka këngë lineare, pa refren, që interpretohen nga një solist; ka me refren, ka duete; ka edhe duete me refren etj. Përfundimisht ky libër përbën jo vetëm një sukses të autorit, por edhe një pasurim të kulturës sonë kombëtare me vlera të njëmendëta.

Një jetë me guxim, me vendosmëri, me punë të palodhur e me qartësi drejt objektivit

Opnioni i z. Ndue Sanaj

Të nderuar të pranishëm!


I nderuar kantautori Fran Kodra!

Sot jemi mbledhur të promovojmë një libër pak ndryshe i titulluar "Një jetë me kangë", me autor kantautorin Fran Kodra, i cili përmban rreth 600 tekste këngësh. Nuk kemi të bëjmë thjeshtë me poezi, por me tekste këngësh dhe të kompozuar e të kënduara deri tani... Një jetë me guxim, me vendosmëri, me punë të palodhur e me qartësi drejt objektivit. Shëmbull për të gjithë, jo vetëm në punën krijuese të Franit, por për këdo që punon e ka të qartë objektivin e ecjes përpara.

Këto këngë, në ketë libër janë të ndara në 10 grupe të ndryshme, që i kane ndare specialistet, por unë si amatore i kësaj fushe, do ti ndaja në tre grupe: Së pari, në grupin e këngëve të figurave e personaliteteve të ndryshme, që kanë lanë gjurmë në fushën historike, në jetën shoqërore të fshatrave, të krahinave e të zonave të ndryshme, përfshi dhe shqiptaret e Kosovës. Nder to mund të ndalemi te kënga e "Preke Thani" ... *Amanet vjen prej mërgimit / me k'ndu kangen në shenje kujtimi ...*, ose "Zek Jakini" ... *Zot çka asht ky Zek Jakini / djalë shoshjan nga Dukagjini ...*, ose "Vase Kiri" ... *Leu Vas Kiri, malet k'nduene / udhëve t' dijes po ma çojnë / mire se erdhe tanë po i thonë / ...*

Së dyti, në grupin e këngëve patriotike, të mallit për vendin, për historinë e bashkësive të fshatrave e trevave të ndryshme të vendit tonë, të kombit tonë. Nder to mund të ndalemi te kënga "Amanet na kanë lanë malet" ... *amanet na kane lanë malet / mos harroni kangët e vallet ...*, ose "Përmendoret e historisë" ... *Për trimni, për bese e sofër / që i ka ruejt çdo prak votër / janë la burrat sipas vendit / prej n' Kosovë e n' Bjeshkë t' Kelmendit ...*, ose "Djelmnia e Dukagjinit" ... *Moj djelmnia Malsisë trime / po t' kndon sot ty zemra ime / n' at vend t' huej fmija që rriten / mos t' harrojnë gjuhen e traditën / nder, besë e bujari / kujt në bote s' ia kemi lakmi ...*

Së treti, në grupin e këngëve të buta apo të grunit, që nen kuptojmë këngët e dashnisë, të humorit e të dasmave. Nder to mund të ndalemi ... "Dashnia e vjetër" ... *Kurrë nuk e provova / si drid-*



het një zemër / veç tash që ndigjova / tuj t' përmend si emër ..., ose "Kurrë mos thuaj se jena nda" ... *Pash një bese e pash njat Zot / mos ta shoh njat sy me lot / se njaj lot herët a vonë / ma shterr zanin përgjithmonë ...*, ose "Moj e mirë ç'ma more anën" ... *Ti pse je në moshën e t' lezetit / fort me sy mos ia ban vetit / sepse bota rrotullohet / me dore qielli nuk tako-*

het / në dashni kush ka mashtrur / vonë a herët asht pendue ...

Po kush është Fran Kodra?

Familja Kodra, që herët ka qene e veçantë për pushke e për pende. Kështu kjo familje në muajin korrik 1915, në kodër Telaj bëjnë një qëndrese tepër heroike. Vat Marku me djalë, Ndoke Vaten dhe nipin Martin Ndoken duke u sakrifikuar me djalë e nip në mbrojtje të kullës e të vendit të vet. Pra, kjo familje duke thithur ajrin e freskët t, duke mos u fshehur erës së Veriut dhe as diellit përvëlues, kurdo e zbulojë veten para njerëzve, punojë shumë dhe kështu plotësoj kuadrin e vete familjar, kuadrin e identitetit të vet. Edhe djemtë e kësaj familjeje, vellazerit Kodra, Frani, Nika e Gjovalini, duke vijuar traditën për të dhënë kontributin e tyre, kane vijuar punën nëpërmjet pendës dhe sot asht para nesh njeri prej tyre, Frani me kontributin e tij, të kantautorit me ketë libër të jashtëzakonshëm në formë dhe në përmbajtje.

Frani me ketë botim, në këndvështrim tim, u tha disa njerëzve, se rolin e librit nuk e zëvendëson asnjë mjet, asnjë rrjet komunikimi. Libri është një e vetëm një, por ne duhet të dimë të lexojmë duke vu në punë arsyen gjatë leximit, duke u largua pasionit, dhe jo vetëm kaq, por të jemi të pasionuar pas librit. Për ketë, Gëte i Madh theksonte: "Njerëzit e rëndomtë dine pak se sa kohe dhe ç'përpjekje i duhen njeriut për të mësuar leximin. Kam tetëdhjetë vjet që lexoj dhe ende nuk e mësova ...". Prandaj, në vecanti të brezi i ri, duhet të lexojnë e të lexojnë, se vetëm duke lexuar njihet e mësohet në tërësi, mësohet historia e jonë, jeta e jonë dhe mund të nxjerrim mësimë prej saj e të ecim përpara.

Frani beri mirë, që këto këngë e ketë punë të disa dekada ta vendosi në një libër, që do të jetë i pavdekshëm duke shkruar në vargje, në tekste këngësh, të vërteten dhe vetëm të vërteten, se gjithënjë, punen me pare ja kaloi arsyes para pasionit. Madje dhe duke i kompozuar e kënduar ato, ashtu siç e njih dhe e ndjen historinë, siç i shikon e vlerëson figurat e historisë e të tjera e të tjera.

Me ketë pune, që keni berë e ndjejë veten mjaft krenar, o bashkatdhetari im, Fran Kodra. Prandaj të uroj punë e vetëm punë të palodhur krijuese në shërbim të vendit tënd, në shërbim të bashkësisë prej nga jemi e ku jetojmë dhe të kombit tonë.

Të lumtë!

Përgatiti Ndue Sanaj



DASMË MONOGRAFIKE NË KLOS: “MOZAIK VITESH ME AROMË FOLKLORI”, I AUTORIT HAMDİ HYSUKA

“Mozaik vitesh me aromë folklori” titullohet libri i publicistit, studiuesit, veprimtarit dhe mësuesit të mirënjohur mat-jane Hamdi Hysuka, libër që u promovua me 15 të muaj të kaluar, në Bibliotekën e Bashkisë Klos. Intelektual, poet, kantautorë, instrumentist valltare dhe folklorist të mirënjohur me gjeografi mbare kombëtare i mblodhi bujtina bujare artistike klosiane. Ishte një dite shtatori me diell të ëmbël si mushiti ku në prag të konakut na priti me Lahuri mjeshtri Ikli Punavija, biri i Mallunxës historike, që gjendet ne varosh te kështjellës Skënderjanë të Set-lushit.

Autori kolegu dhe bashkëpunëtori Hamdi Hysuka kishte zgjedhur përvjetorin e 20-të ngjites në skenë të mikut të tij si ditën e promovimit autobiografisë së mjeshtrit të veçante matjanë. Ikli rritur në prehrin e mjeshtrëve veteran si Ymer Nelaj, Ibrahim Minxhozi, Feride Kurti, Hysen Kanxhari, Sali Kurti, Ali Mulaj, Qamil Beshtaku, Behar Neli e të tjerë.

Instrumentisti shumë dimensional Ikli Punavia, biri dhe baba i suksesit, është vetëm 32 vjeç dhe ka realizuar ëndrrën më të madhe të jetës duke u pushtuar në kreshtat e larta të suksesit artistik në fushën e folklorit.

Si vogëlush i talentuar është ngjitur në skenë, në vitin 2002 dhe që prej asaj dite nuk ju nda as një çast asaj malorje të mundimshme që çonte drejt lartësive. Njomzaku i çapkën, ngarkuar me torbën shtegtarit mori shpatin përpjetë i nxitur nga një vullnet i pa epur mbarsur me një

talent futurak. Me studim, pa gjumësi pune dhe vetëm pune hedhësi i balona “desantoi” skena festivalesh koncertesh, tubimesh kulturore në mbarë hapësirën gjithë shqiptare, duke demonstruar art



virtuozitet dhe mjeshtri shembullore.

Që në vegjëli u beri shoqëri bilbilave me fyell e bilbil dhe gjithë instrumentet frymore. Çiftelisë ja puthi telin, me sharkinë u dashurua dhe u bë dhëndër i luarisë pa dyshim kryeparik i këtij instrument autentik matjan.

Ikli punavia ka kaluar të gjitha shkallet e një artisti duke filluar nga qendra Kulturore e fëmijëve, teatri i kukullave Burrel, instrumentist i Ansambllit Folklorik Mati, drejtues i Grupit folklorik

“Petrealba” apo edicionet plote sukses të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtarë, “Fest Folk Klosi 2018 dhe 2019”.

Për mese një dekadë e gjysme Ikli Punavine e shohim në rolin e snajperit në



festivale dhe veprimtari folklorike kombëtare jashtë atdheut në çdo pëllëmbë të Kosovës, në Maqedoni, Mal të Zi, Greqi, Turqi, Zvicër e Amerike. Marshoi me hapin pupël të valltarit nga njeri qytet i shqiptarisë në tjetrin, nga njeri shtet në tjetrin, çoi zërin kumbues të bilbilit, tingujt e përkëdhelës të çiftelisë dhe jonet misterioze të lahurisë. Në mitingjet ndërkombëtare në Selanik, në Tetovë, Prizren përçoi vlerat ballkanike të flokut, po ashtu Ankara, Zvicër dhe gjetkë.

Ikli është një vrapues, zoti i garave të gjata me pengesa, është gjithnjë në rritje dhe kërkues ndaj vetes si instrumentist i vlerave autoktone, model shembullorë i një artisti në karrierë, mbledhës i zellshëm i folklorit, hulumtues i dashuruar pas talenteve të reja iniciatorë dhe menaxhues i spikatur i jetës kulturore në Bashkinë Klos dhe Rrethin e Matit.

Dasma monografike “Mozaik vitesh me arome folklori” e autorit Hamdi Hysuka pati krushq këngëtare nga Tetova, Hajri Ismani, Besart Abdurahmani, Dashmir Saiti, nga Shkodra Gjon Kosteri, nga Malisheva, Shaban Bytyqi së bashku me djalë e tij, nga Lezha, Llesh Gjini Prenga së bashku me djalë e tij artist popullorë. Veprimtarinë e vlerësuan me praninë e tyre nga Bashkia Klos, Aishe Kodra, Kanarina Çeka, Dinë Gjini, Ish-kryetari i Bashkisë Klos zoti Ramazan Mjeshtri, anëtarë të grupit folklorik «Petrealba», Avni Hoxha, Man Xhepi, Resul Fatmira Baleta, Sajme Kurti, Adhurim Xhepi, Sokol Xhepi, Mane Hoxha, kryetari i Klubi Letrar “Pjetër Budi” Mat, Fiqiri Zeneli, Shkëlqim Disha e të tjerë.

Një urim i veçantë nga Londra online bëri autori matjan emigrantë në Londër, zoti Xhavit Gasa. Një dreke bujare buze burimeve fladitëse te Lokali “Freskia” me vere dhe buqeta këngësh nga artistet pjesëmarrës ishte torta urimore ëmbël-tore për artistin Ikli Punavia!

Prelë Milani

Ndahet nga jeta Gjergj Pal Cigarja

Ndahet nga jeta Gjergj Pal Cingaria nga Toplana, njeriu që përfaqësoi për shumë vite virtytet më të larta të maleve të Dukagjinit si këshilltarë në komunën e Shllakut.

Sot, në bjeshkën e Toplanës u shemb një shkëmbe malit të Toplanës, është ndare nga jeta Gjergj Pal Cigaria, në moshën 63 vjeç, i cili që në rininë e tij dallohej për shkathtësinë e tij. Vinte nga fisi Geraj, ku ishte rritur në oxhakun e shtëpisë së madhe, me urtësinë e fjalës e nderit.

U dallua për guximin e tij në kuvende burrash me miqtë si njeri me fjalën e tjerre me humorin e tij të holle, duke punuar me një përkushtim të pa kufi në mbrojtjen e të drejtave të fshatit Toplan e lagjen Serme.

Në vitin 1992 zgjidhet anëtarë Komune në Shllak dhe më vonë zgjidhet N/Kryetar i kësaj Komune. Ishte pjese i atyre këshilltareve, që ishin burra pleqnie se sa përfaqësonin forcat politike. Koha që e njoha këtë oratorë, që në çdo mbledhje kumbonte zëri tij për të drejtat e vuajtjet që kishte kaluar Toplana kreshnike. Zëri i tij në çdo takim me përfaqësues të ministrive e parlamentit nuk e ndalte, duke kërkuar të drejtat e banoreve të tij. Vitet e fundit punoj pranë H/C Koman, ku u dallua për korrektesën e vlerat më të larta të familjes. Vdekja e parakohshme na pikëlloj pa mase!

I shprehim ngushëllime familjes e të afërmeve për humbjen e këtij fisniku, që respektonte kudo në Dukagjin. Kështu familja e të afërmit dhe Toplana humbi një orator të fjalës së lire. Pushofshi në paqe në lumnin e qiellit!

Zef Nika

PROSORI PJETËR NDOU, KRENARI NIKAJ-MËRTURËSE, SOT NË 85 VJETORIN

Me rastin e 85 vjetorit të lindjes është kënaqësi të shkruash për mikun, kolegun, intelektualin e Nikaj-Mërturit Pjetër Ndue Marticanaj. Ai për 37 vite nuk u tërhoq përballë veshtersive kohës së keqe e largësisë nga familja në përhapjen e kulturës e dijes në zonën e Nikaj-Mërturit, e më gjërë, që nga, Gegyseni, Curraj Eper, Palç, Lekbibaj, Peraj, Gjonpepaj etj. Aty, në arsim e g'dhendi emrin e tij me kembenguljen dhe dashurinë, përkushtimin e profesionalizmin e tij në përhapjen e dijes dhe vlerave më të mira të kësaj zone duke ardhë nga një familje e elitare me taban, si puntore e mikepritesë ndër breza. Prosor Pjetër Ndue me punën e tij ka fituar mirënjohjen e respektin e të gjithëve me ëmbëlsinë e komunikimin dhe fuqinë e argumentimit, duke kryer edhe detyra shoqërore të pushtetit e duke shuar mosmarrveshjet në komunitet, duke u radhitur në krenarinë e intelektualëve të Nikaj-Mërturit. Për aftësitë dhe kontributin e tij në 100 vjetorin e hapjes shkollës parë shqipe në Malsinë e Gjakovës në Gjonpepaj, Ai është nderuar me “Çertifikatën e mirenjohes” nga Bashkia e Bajram Currit. Ai sot është me banim në Tiranë dhe ndihet krenarë e minjohës dhe i respektuar nga ish nxensit, kolegët, bashkë krahinasit, familja bashkëshortja, pesë djemët dhe vajza me arsim të lartë të martuar e stabilizuar, si dhe nipat e mbesat që ja shtojne lumturinë. Në këtë 85 vjetor i urojmë jetë të gjatë e lumturi, me shëndet dhe gjitha të mirat në gjirin tonë familjarë!



Kole Buja

TAKIM ME RASTIN E 50-VJETORIT TË IMO-S

Në kuadrin e 50-të vjetorit të themelimit të njërit nga institucionet kërkimore-shkencore të bujqësisë shqiptare – Institutit të Misrit dhe të Orizit, si dhe të daljes së një libri kushtuar këtij institucioni, ditën e shtunë, me datë 2 Tetor 2021, u zhvillua një takim ceremonial.

Në këtë takim morën pjesë: ish punonjësi të IMO-së, familjarë të ish-kërkuesve shkencorë të këtij instituti (që nuk jetojnë më), përfaqësues nga organizata lokale dhe kombëtare, përfaqësues nga UBT (dhe deleguar nga Akademia e Shkencave), përfaqësues nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, gazetarë, e të tjerë.

Në fjalës e hyrjes, drejtuesja znj. Mirela Pjetrani, ndër të tjera tha:

Instituti i Misrit dhe i Orizit u ngrit në Shkodër, mbi bazën e punës së filluar që më parë nga disa specialistë, në ish ndër-marrjen e quajtur Stacioni i Zooteknisë (e njohur si zooteknika e Shkodrës). Themelimi i këtij Instituti erdhi në një moment delikat dhe të vështirë për vendin dhe sidomos për bujqësinë: popullata nuk arrinte të “ngihej” me bukë. Dhe misionin për të përmirësuar gjendjen e mori një grup specialistësh tashmë shumë të njohur në të gjithë vendin, të cilët, nisur nga një fushë “gati djerrë”, bëri revolucionin në mbi dyfishimin e prodhimit të prodhimit të misrit në të gjithë sipërfaqen e mbjellë në vend.

Është e kuptueshme që rrethanat historike, politikat e kohës dhe faktorë të tjerë kishin ndikimin e tyre në inicimin dhe deri në vënien në eficientë të kësaj qendre kërkimore, por faktori njeri, prania e specialistëve të bujqësisë (që më vonë u bënë shkencëtarë të vërtetë, që morën grada e tituj shkencorë), në Shkodër, si Hysen Laçej, Ahmet Osja, Menduh Dibra, Lazër Çapaliku, Gjergj Dionisi e Ton Naraçi dhe biokimisti i talentuar Ilia Leka, ishin faktorë me shumë rëndësi. Më pas, këtij stafi të specialistëve iu bashkuan edhe të tjerë, dhe të gjithë bashkërisht arritën të konsolidojnë punën, të hartojnë e zbatojnë plane që e bënë këtë Institut, me kaq rëndësi për ekonominë e vendit dhe me kaq famë, si në vend ashtu edhe jashtë.

Në vite, në IMO, stafi erdhi duke u shtuar dhe duke u kualifikuar, i aftë të marrë përsipër dhe të zgjidhë çështje shkencore, ashtu edhe ato praktike në lidhje me bimën e misrit dhe të orizit, por edhe të grurit dhe disa bimëve të tjera të arave. Kjo u bë e mundur duke marrë pranë këtij instituti, specialistë të përgatitur dhe të përkushtuar të cilët dhanë kontributin e tyre në vite. Nga ana tjetër, për IMO-në u përcaktua një sipërfaqe e konsiderueshme e tokës së punueshme (fshatrat Dobraq dhe Golem), si dhe u fuqizua me mjete pune dhe makineri bujqësore. Si rezultat e punës së madhe të kryer, IMO-ja mori emër në të gjithë vendin, pasi arriti të prodhojë farë hibride në sasi të mjaftueshme që të mbulojë gjithë sipërfaqen e mbjellë me misër në vend, si në kulturë bazë, ashtu edhe atë hamullor dhe për silazh.

Instituti është vizituar nga personalitete të shkencës bujqësore të Kroacisë, Bull-

garisë, Rumanisë, Hungarisë, Francës, Kinës, Koresë, Kubës, Meksikës, Perusë, Italisë, Japonisë, Turqisë, Greqisë, Kosovës, SHBA e të tjera. Nga Instituti, kanë shkuar në institute homologe në ish-Jugosllavi, Greqi, Bullgari, Rumani, Hungari, Itali, Kinë, Kore, Francë, Spanjë, e të tjera. Të gjitha këto kanë nxitur stafin për të punuar më tej, kanë ndikuar në shtimin e arritjeve, duke e kthyer institutin në një institucion bashkëkohor,



një me kërkesat e bujqësisë së vendit dhe gjithnjë në pararojë të punës.

Por, duke parë që në ditët e sotme, kur pas ristrukturimit të sistemit kërkimor-shkencor në bujqësi, si objekti ashtu edhe struktura e ish IMO-së kanë ndryshuar, kur ka ndryshuar pothuajse plotësisht qasja ndaj kërkimit shkencor në bujqësi dhe në produktet e prodhimit bujqësor, kur jemi në një fazë ku brezi i ri nuk ka ku të gjejë informacion rreth IMO-së, përkujtimi i datës së themelimit të IMO-së merr një rëndësi të veçantë.

Në vijim, fjala iu dha Z. Lazër Çapaliku, ndër themeluesit dhe ish drejtor i IMO-së për të paraqitur një përmbledhje të rrugës së IMO-së. Ai tregoi për sfidat me të cilat i përball stafi në fillimet e punës, në hartimin dhe zbatimin e metodikave korrekte shkencore, në organizimin e punës në prodhimin e farës, në shumëzimin e saj dhe në përhapjen për të gjitha ekonomitë bujqësore të kohës. Me punë shumë këmbëngulëse, pa shikuar oraret, por duke u bazuar në parimet shkencore, brenda disa vitesh u arrit që të prodhohej farë hibridë me të cilën u mbulua në masën 100% e gjithë sipërfaqja e mbjelle me misër: misër kokërr, misër hamullor



dhe për silazh (që në atë periudhë i kalonte të 100 mijë ha në gjithë vendin). Me ndryshimin e sistemit, IMO-ja vazhdoi në rrugën e nisur, por në fillim heqja e inventarit të tokës (iu nda fermerëve), prishja e bazës mekanike, shkurtimi i fondeve dhe më në fund ndryshimi i destinacionit (në Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore) dhe i fokusit të punës, kanë bërë që ky “Institut” të tkurret në vetvete. Megjithatë, ajo pak farë që vazhdon

kanë marrë pjesë në komisione të ndryshme. Kohët e reja, kanë sjellë edhe situata të reja, ne formën e organizimit dhe të menaxhimit, por është e mundur që puna dhe arritjet e këtij Instituti, të mos mbeten në letër, të mos trajtohen si kujtime, por të mund të ruhen e zhvillohen më tej. Në këtë kuadër, dera e UBT-së është e hapur për bashkëpunim, për hartimin dhe zbatimin edhe të projekteve të përbashkëta. Shembull pozitiv është vazhdimi (ndonëse në shkallë të vogël) të prodhimit të farës së hibrideve “Rozafa”, ashtu edhe kultivimi i orizit nga “Mrizi i Zanave”, me farëra të siguruar nga ish punonjësi i IMO-së, tashmë shumë i njohur dhe i suksesshëm në Verçeli, Itali, Dr. Filip Haxhari. Pra, mundësitë ekzistojnë, duhet të bashkëpunojmë që ti shtyjmë më përpara arritjet.

Znj. Diana Mlloja Kastrati, përfaqësuese e Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës solli përshëndetjet e grupit të këtij institucioni në përvjetorin e IMO-së. Ajo u fokusua në bashkëpunimin institucional që ka ekzistuar në vite: mjaft nga punonjësit shkencorë të IMO-së kanë qene të angazhuar si pedagogë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, ashtu si edhe studentë të këtij universiteti kanë kryer praktikat pranë IMO-së oje janë angazhuar në realizimin e temave studimore.

Duke qene në Shkodër, ishte parashikuar një intermexo me dy nga humoristet e njohur të këtij qyteti: Qazim Çela dhe Gac Kodrina për një përshëndetje me humor me misrin dhe për misrin, ku batutat ishin të lidhura me IMO-në dhe me misrin.

Në fund, iu dha fjala ish punonjësit të këtij institucioni (tashmë pjesë e Instituti i Resurseve Gjenetike Bimore që operon si pjesë e UBT-së), Z. Zef Gjeta, autori i librit për 50 vjetorin e IMO, i cili u përquadrua në disa komente rreth punës së realizuar prej tij në librin me titull: “Institutit i Misrit dhe i Orizimit – IMO Shkodër, Një gjigand i shkencës shqiptare – Vështrim historitë Shtator 1971 – shtator 2021”.

Me iniciativë nga Instituti i Kërkimeve Rurale (një OJF që operon në fushën e zhvillimit rural), u ndanë Certifikata MIRËNJOHJE, për punonjësit dhe ish-punonjësit staf i kërkimit shkencor në IMO, për kontributet e tyre ndër vite: Prof. Hysen Laçej, Prof. Ahmet Osja, Prof. As. Dr. Menduh Dibra, Prof. As. Dr. Konstantin Hajkola, Agr. Lazër Çapaliku, Dr. Filip Haxhari, Dr. Zhaneta Miloti, Dr. Ilia Leka, MSc. Vildan Gokaj, Dr. Qamil Sokoli, MSc. Bahri Guskijqi, Agr. Jup Dyli, Agr. Kristina Linadi, Dr. Naim Laçej, Dr. Refik Shema, Agr. Agim Dudushi, Dr. Fehmi Gokaj, Agr. Gjergj Dionisi, Agr. Ton Naraçi, Agr. Mustafë Kraja. Motivacioni ishte i përafërt: “Për kontribute të shquara në punën kërkimore-shkencore me bimën e misrit/orizit, në krijimin e hibrideve dhe përhapjen e tyre në shkallë të gjerë, si dhe për punën drejtuese në sektorë të këtij institucioni”.

Prof. As. Dr. Zef Gjeta

MUZIKA QYTETARE SHKODRANE-2021

Zemra ju këndoftë artistë të nderuar shkodranë

Të flasësh për Ahengun Shkodran, ta pasqyrosh atë, jo si një studim, por si një aktivitet real që tashmë, prej nëntë vitesh, ka dhe një datë të caktuar celebrimi para artdashësve shkodranë, është jo vetëm përgjegjësi, por edhe kënaqësi e madhe.

Do duhet të bëhesh pjesë e tij, qoftë edhe si spektator, që të kuptosh se sa të shumta janë veçoritë dhe vlerat që mbart dhe bën të paarrtshëm këtë aktivitet. Ky aktivitet, tashmë i përvitshëm mirëpritur tamam si ato dasmat motit që kishin një datë të caktuar, ku të gjithë përgatiteshin muaj të tërë për ta përjetuar atë me të gjitha detajet e gëzimit e dëfrimit. E tillë është edhe nata e "Ahengut Shkodran" koncertit popullor që zhvillohet çdo 29 shtator dhe përkon me Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, çka vazhdimisht ka nxitur interesin e qytetarëve dhe institucioneve për t'u parapërgaditur sa më denjësisht, tamam si familjet shkodrane për natën e dasmorëve.

Në këtë dasëm të improvizuar me perlat e këngëve qytetare shkodrane, inskenuar në një oborr të mrekullueshëm ku kundërmojnë luleborat, karafilët e trëndafilat, ku banesa me shkallët e ngurta, çardaku, pusi me çikrik rrethuar nga avullitë e larta me gurë Kiri, të kujtojnë edhe djepin ku lindën e u rritën këto pasuri shpirtërore të një qyteti.

Për të gjithë ata që nuk e dinë, zanafilla e vërtetë e "Ahengut Shkodran" lidhet pikërisht me ritet e dasmës, të cilat në qytetin e Shkodrës ishin unike në llojin e vet, sado që edhe krahinat përreth kishin karakteristika mjaft të ngjashme me ritet e "Ahengut Shkodran", pasi siç thonë, folklori nuk lejon dhe as nuk njeh kufinj. Sipas etnologeve "Ahengu Shkodran" ka lindur që në kohën e Bushatllinjve pra, para më shumë se 200 viteve, ku për atë kohë lindi si një risi dukurish të civilizimit qytetar për t'u kultivuar më pas me një fanatizëm të pasiq duke ruajtur deri në detaje ritet e dasmës së vjetër shkodrane.

Ahengu Shkodran edhe sot e kësaj dite të ngjan me një koncert të mirëorganizuar, i cili në vetvete ka gjetur edhe përshtatjen e këngëve dhe valleve sipas kohës ditore kur dasma kryen ritet e veta, që nga sabahi deri në aksham (mëngjesi deri në mbremje).

Ahengu shkodran, që nga lindja e tij ka qenë dhe është një institucion artistik e kulturor i përbërë nga poetë, kompozitorë instrumentistë e këngëtarë, të cilët jo vetëm arrijnë të ruajnë vlerat e tij që nga krijimi, por edhe t'i kultivojnë e trashëgojnë në breza. Prandaj "Ahengu Shkodran" është gjithmonë vital e i kristaltë si një burim me ujë të kristaltë që nuk shteron kurrë. Muzikantët dhe këngëtarët e "Ahengut Shkodran" ruajnë dhe interpretojnë motivet e vjetra të këngëve dhe valleve më të hershme, por njëkohsisht krijojnë edhe këngë të reja, brez pas brezi gjithnjë duke ruajtur karakteristikat që lejon ky institucion.

E veçanta e kësaj pasurie të paçm-



ueshme është se ajo nuk është pasuri e një grupi muzikantësh, por e mbarë një qyteti që është një ansambël i madh artistik dhe

njëkohësisht edhe memoria e albumit artistik të "Ahengut Shkodran" në shekuj. Në dasma e gëzime të gjithë shkodranët

këndojnë e dëfrenë duke i shoqëruar ato me vallet tradicionale palë-palë, me tematika epike, lirike, por edhe satirike ku spikasin edhe rrobat e bukura me vlera unike.

Më lart u shpreha se në këtë shkrim nuk do të merrem me studimin e "Ahengut Shkodran" pasi është një temë shumë e gjërë, por kur pasqyrosh një aktivitet të tillë nuk ke nga t'i ikësh pak edhe kësaj fushe.

Kështu pra më 29 shtator, datë që përkon me Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, në një mbremje të freskët të fillimvjeshtës nga Qendra Kulturore "Pjeter Gaci" u organizua edicioni i 9-të i koncertit madhështor "Ahengu Shkodran" në bashkëpunim me Muzeun Historik të Shkodrës dhe me mbështetje të Bashkisë Shkodër.

Organizimi me pasion e profesionalizëm i "Ahengut Shkodran" është një obligim ndaj kësaj pasurie, që ca vite më parë me të drejtë u etiketua si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë kulturore kombëtare, pasi ai mban gjallë një krijimtari të paçmueshme, mban gjallë dashurinë, respektin dhe memorien ndaj gjithë kësaj game kulturore të pastër dhe origjinale që nxit brezat ta ruajnë, trashëgojnë dhe ta kultivojnë edhe nëpër gëzimet familjare. Veç kësaj "Ahengu Shkodran" nxit kultivimin e artit popullor ku hyjnë ritet shpirtërore, këngë e valle që i aplikojmë duke i gërshtur edhe me artizanin e punës me dorë nga veshjet tek instrumentat e më gjërë.

Edhe në këtë edicion nën drejtimin e udhëheqësit artistik z.Bardhyl Hysa, drejtuesit muzikor Ilir Zoga, moderatores Gentiana Daka dhe koreografit Aldo Nika erdhën mjaft bukur interpretime këngësh



Si u bë Hoti bajrak i parë në Malësisë së Madhe



Shkruar nga
Prof. Gjon Frani Ivezaj

Sipas gojëdhënave që na vijnë si dëshmi mbi organizimin fisnor në malet e Malësisë së Madhe, Hoti nuk ka qenë bajrak i parë sikurse mbahet sot. Mbi këto të dhëna dhe fakte historike dëgjohet fliste edhe plakun 108 vjeçar, Nike Smaka, diku në rininë time të hershme, tek tregonte mbi bëmat dhe trimëritë e të parëve të Kullës së Bajraktarit të Hotit.

Ai thoshte se bajrak i parë ka qenë Kelmendi, i dyti Gruda, mandej i treti vinte Hoti e të tjerë me rrallë. Sipas tij në vitin 1765 i pari i Hotit ishte Luc Gjoni prej Junçajve të Hotit, i cili së bashku me 20 djem, sokola të Hotit në betejat krah Turqisë për shtypjen e revoltave anti osmane në afërsi të Ulqinit arritën të korrin shumë fitore kundër venecjanëve, duke u bërë kështu dora e fortë e ushtrisë turke për 12 orë pa ndërprerje, aq sa venerianet të tmerruar u larguan me aniet e tyre drejt Raguzës apo Dubrovnikut të sotëm. Gjate atij armëpushimi ushtria turke zhvendoset në Kështjellën e Shkodrës me të vrarët, të plagosurit dhe robërit veneciane.

Aty Veziri i Shkodrës u kishte dhënë urdhër të mblidhet e gjithë ushtria pjesëmarrëse në atë betejë dhe si diplomat që ishte vendos të testojë aftësitë fizike të krerëve të maleve kundrejt një shpërblimi për pozitë në vendimmarrje, ku edhe pohon se, "Ai që do fitojë, do ketë një shpërblim të madh!" Sipas gojëdhënave të Nikës, por edhe të pleqve të tjerë gati një moshë me të cilët zinin e kuvendonin në një bregore në shulla kundruall shtëpijave. Në njërin nga ato ushtrime luftarake ishte edhe vendosja e faculetës së bardhë mbi grykat e 24 topave të vendosur përgjatë mureve të Kështjellës së Rozafës. Luc Gjoni edhe pse një burrë shtatvogël, me atë zhdërvjelltësinë e tij arriti i pari ta vendosi faculetën mbi topa. Kjo fitore do ti jepte atij përparësi juridike në vendimmarrjen e Vezirit, i cili në sytë e të gjithëve e urdhëroi të paraqitet në mëngjes në ofiqin e tij. Me tu paraqitur në zyrë Luc Gjoni, Veziri e pret me nderim, për aftësitë e tij. E pyet për familjen dhe aty i tregon se kam dy djem, Niken dhe Vuksanin. Atëherë Veziri i propozon të marrë detyrën si prijës i krejt Malit të Hotit dhe Hoti të jetë mal i parë ndër malet e Malësisë, me kushtin që njëri nga dy djemtë e tu të kthehet mysliman, ku i veçon Niken. Pastaj Veziri i thotë se: "Nëse ju e pranoni këtë kusht do nënshkruaj që të gjithë hotjanët të çlirohen nga detyrimi ushtarak i nizamit në kufijtë e largët të perandorisë, dhe detyrimin ushtarak ta kryejnë me shërbesa këtu në Shkodër ose zonat e afërta, dhe veç kësaj të gjithë hotjanët janë të çliruar nga detyrimi laksativ i tregut në Shkodër".

Luca ashtu mendueshëm e falënderon Vezirin dhe i thotë, meqë po më ven këtë kusht unë për pa pyet Traboinin e Hotit nuk mundem me vendos ndaj më jep kohë një javë ditë. Ishte ditë e marte, të dielën u bashkuan te kisha e Hotit, ku Luc Gjoni kishte hipur mbi një gur varrit aty në oborrin e kishës dhe kishte thanë: "Pa dëgjoni vellazër, të martën jam kenë tek Veziri i Shkodrës, ku me ka bërë këto propozime, me kushtin që djalin e madh Niken me kthye mysliman!" Pas disa orësh diskutimesh në kuvend hotjanët e pranuan kushtin e Vezirit që djali të kthe-

het mysliman, por që kur ti vij vakti me u martua të martohet me një vajzë malësore katolike. Këtë vendim të kuvendit të Hotit Veziri e mirëpreti i vetëdijshëm se, kush kthehet mysliman nuk mund tu rezistojë dhuratave joshëse të tij. Kështu me fermanin (vendimin) e posaçëm të Vezirit të Shkodrës, Luc Gjoni u bë Bajraktari i Hotit, me pëlqimin e Traboinit dhe të Rapshës. Për këtë arsye Veziri i thirri të gjithë malësoret në Kështjellë, ku ju shpalli vendimin se Luc Gjoni do jetë Bajraktari i Hotit dhe se djali i tij Nika, me pëlqimin e tij dhe të gjithë Hotit do kthehet mysliman dhe do marrë emrin Mehmet, Mehmet Luc Gjoni, për të cilin në fakt ka shkruar edhe Ippen Teodor në dorëshkrimet e veta. Sa i takon ofiqin të bajrakut dihet botërisht se ishte i trashëgueshëm nga baba te djali, gjë që Veziri e kishte para përgatitur me kohë qëllimin e tij, që atë ofiq ta gëzonte dhe trashëgonte një mysliman, i cili do ta ndihmonte me realizua planet e veta në Malësi.



Kulla e bajraktarit të Hotit, që ia kanë ndërtua Turku, për interesa të veta, në vitin 1880

Kështu vite më vonë veziri i dhuron

me tekst të Ramazan Çekës, muzika nga maestro Zyhni Beqiraj e kënduar nga këngëtarja Bruna Sata, të ishte pjesë e "Ahengut Shkodran". Orkestra e mrekullueshme që drejtohej nga mjeshtri Ilir Zoga i dha vlerë të jashtëzakonshme këtij koncerti. Oborri i shtëpisë karakteristike shkodrane të Oso Kukës, ishte i tejmbushur që një orë para se të fillonte koncerti, i

edhe disa hektar tokë aty ku gjendet edhe sot Kulla e Bajraktarit të Hotit në Kushe, në të cilën ma herët e gëzonte i gjithë fisi i Jonuthit, Juncajt e sotëm duke i shfrytëzuar bashkinat, shtëpinë dhe varrezat e tyre tashmë si pasuri që i përkiste Kullës dhe familjes së Bajraktarit.

Diku rreth Shëngjergjit në vitin 1880 Veziri pasardhës i Shkodrës investon për ndërtimin e Kullës së Bajraktarit, të cilën e quante si nevojë imediate shtetërore për shfrytëzim si pikë referimi për korrierët, lajmëtarët apo takimet me malësoret e Malësisë së Madhe, të cilën kishin prurur mjeshtër të ditur me e punua si kullat e qytetit.

Shumë kush mahnitej prej punës së tyre në ndërtimin e asaj ndërtese, me gurë të latuam e me qemerë të mëdhenj si me kenë ofiqet e Vezirit thoshte Nika. Megjithatë edhe pse Veziri i kishte me sy të mirë atë familje, ata asnjëherë nuk i shiten interesat e malësoreve dhe në veçanti ato të hotjaneve, por punuan e luftuan me urti e trimëri me i zbardhe faqen malësisë dhe vlerave të saj.

të vjetra të kënduara me shumë dashuri nga zërat e rinj të këtij qyteti si: Eldis Arnjeti, Niki Mjeda, Klodiana Vata, Xhuli Pjetraj, Ademir Fresku, Glerdit Turmetaj, Klinsman Lazani, Bruna Sata, Megi Toma, Martina Serreqi, Ivan Tanushi, Adelina Correj, Laorjan Ejlli, Savjana Vjerdha, Rezarta Smaja, Blerta Cina, si dhe Leonard Guga. Gërshetimi aq këndshëm e natyrshëm me

mjeshtër e këngës si Bujar Qamili, Grupi "Karafilat", valltarët dhe instrumentistët të veshur bukur me veshjet tradicionale, premtori për vazhdimësi dhe rritje të sigurt të këtij folklori në djepin e Kulturës Shkodrane.

Lidhur me këtë vazhdimësi e pasurimi organizatorët kishin menduar që një nga këngët pjesëmarrëse të Festivali "Luleborë" me titull "Për ty lule dhe këngë"

me tekst të Ramazan Çekës, muzika nga maestro Zyhni Beqiraj e kënduar nga këngëtarja Bruna Sata, të ishte pjesë e "Ahengut Shkodran".

Orkestra e mrekullueshme që drejtohej nga mjeshtri Ilir Zoga i dha vlerë të jashtëzakonshme këtij koncerti.

Oborri i shtëpisë karakteristike shkodrane të Oso Kukës, ishte i tejmbushur që një orë para se të fillonte koncerti, i

cili ishte planifikuar për në orën 19.00. Spektatorët, si në një natë dasme të vërtetë kishin ardhur më herët për të gëzuar e dëfryer. Dhe ashtu ndodhi: këngët nuk u shoqëruan vetëm me duartrokitje, por edhe me korin e tyre të mrekullueshëm.

Ramazan Çeka



Muaji nëntor është aksion në lufte kundër duhanpirës. Duhani dhe demet e tij



Dr. Med. Ndue NIKAJ

Dr. med. Ndue Nikaj

Pathalog-Internist-Shkodër

Varësia nga nikotina, disa mënyra për arritjen e lënies së duhanit. Sipas të dhënave të organizatës botërore të shëndetësisë (OMS) duhan pirja vret çdo vit afro 6 milion vete në bote. Nikotina Tabacum, i cili merret në formë cigareje ose digjet në çibuk (lulle), thithet në formë pluhuri me hunde (burnut) ose përtypet në goje.

Efektet farmakologjike dhe disa pasojat patologjike vijnë nga Nikotina alkaloidi kryesor që përmbahet në duhan, e cila ka veprim të ngjashëm me adrenalinën e sympatikomymetike të tjerë dhe është përgjegjëse për ndërlikimet e dhëna si dhe për varësinë e individit (toxicodipendenca). Pra tymi i duhanit indukon varësi psikologjike dhe farmakologjike; intensiteti (shkalla) e veprimit ndryshon nga një person në tjetrin. Varësia e sjelljes dhe ajo psikologjike është e lidhur me zakonet personale dhe sociale (ritet) që janë krijuar në vijimësi nga refleksat autentike të kushtëzuara; që mbahen amplifikohen nga vetitë pro-aktive të Nikotinës. Kur niveli i Nikotinës në gjak bie në një nivel të caktuar ndjehet nevoja për të si detyrim i pa kthyeshem për ndezjen e cigares (compulsion). Duhani ka një numër të madh lendesh të dëmshme për organizmin, si: mono-oksidi i karbonit (CO), që dëmton endotelin e enëve të gjakut, që lidhet me hemoglobininë e gjakut në të ashtuquajturën karbooksihemoglobolina (Hb-CO, që shton numrin e rruzave të kuqe të gjakut (eritrocitet), rrit agregimin e pllakave të gjakut (trocitet) dhe shton viskozitetin, çon në tromboza, infarkte deri hemorragji cerebrale (stroke), infarkt të zemrës e të tjera:

Në France aktualisht 24% e popullsisë pijen duhan!

Po ashtu nga djegia e duhanit me letër prodhohet amoniak (NH₃) dhe aldehide; lende ngacmuese të frymëmarrjes duke dhënë kolle, trakeo-bronkrite, ka arsenik, katione benzopirenesh me veprim kancerigjen, ka cianure që bllokojnë frymëmarrjen indore dhe kësajsoj shtohet rreziku për kancer nga 10-30 here tek duhanpirësit krahasuar me jo duhanxhinj.

Duhani është një bime e përvitshme që u pru në Evropë nga vitet 1500, në vitet prekolumbiane i cili vendosej në kostume, përdorej në raste ritesh religjiozë nga etrit indigjen nga veriu në jug. Në France duhani ishte monopol shtetëror, që në 1624 dhe cigaret e para u futën vetëm në vitin 1825

Duhani pihej nga azotiket me pipa dekorativ (qelibar) ose puro nga gjethe duhani, megjithatë priftërinjtë e bënë pluhur në kuti të vogla dhe e merrnin duke e thithur me hunde (burnut) ose e mbanin në goje si rrënje karafila.

Shumë amerikan e pinin me djegie ose e shpërndanin pluhur si oferta për shpirtin duke iu drejtuar Hyjtë. Në fillim duhani përdorej në mënyrë krejt vullnetare, por shpejt u konstatoi varësia psikotrope dhe kështu u përhap me shpejtësi kudo. Pra, duhani ka shtrirje të gjere, sido që është vërtetuar se dëmton rende shëndetin, me sëmundje të mushkrave, me ngulshim, astma, kancer në buze, laring dhe në mushkëri (ku përbën mbi 90% shkak direkt).

Dihet se nikotina në gjethet e thata të duhanit ka përqendrim nga 0,6-9%, ajo në doza të vogla ka veprim stimulues-eksitues dhe në doza të mëdha frenues. Pirja e duhanit sidomos për moshat e reja dhe në veçanti femra ka rritje galopante, pirja e duhanit (tymosja) shkakton më shumë vdekje se gjithë faktorët ndotës të ambientit të marre së bashku. Kancerit i dedikohen me tepër se nikotinës, 3-4-benzopireneve. Pirja e duhanit cenon çdo ind dhe organ, prish metabolizmin në tërësi vështirëson veprimtarinë e gjithë organeve, rrit koagulimin, shton kolesterolin, dëmton pankreasin; jep gastrit, ulcera, ul motoriken e zorrëve, ul oreksin, ul rezistencën ndaj shumë sëmundjeve, dëmton spermatogenezën (qelizat mashkullore-Y), që çon deri sterilitet, por dëmton më tepër, qelizat me kromozom seksual "Y"; gratë me barre që pine duhan, lindin fëmijë nën peshe dhe me probleme me mushkëritë.

Duhet të kemi parasysh se ndryshe nga fillimi që ishte një akt veprimi i zgjedhur me vullnet krejt personal, plotësisht të lire, por tashme me kalimin e kohës transformohet në nevojë detyrues, aq sa nuk mund të ndërpritet lehtë ky ves i tymosjes, por do një vullnet të forte, sepse pas ndërprerjes e ndjen veten keq.

Kështu lenia e këtij vesi në moshe madhore a më të re (nen 40 vjeç) do të ulte rrezikun për sëmundjet e zemrës dhe të enëve të gjakut (kardio - vaskulare) me 90% krahasuar me duhanpirësit aktiv.

Është vonë të lini duhanin sot?!

Pra tani kemi fenomenin e varësisë nga Nikotina (Toxiko-dipendenca) si në rastin e drogave të forta. Pikërisht për

ketë OMS-I (organizatë botërore e shëndetësisë) vesin e pirjes së duhanit si për drogat tjera e vlerëson gjendje psikikë dhe here-here fizike rezultat të ndërvarur ndërmjet organizmit dhe drogës (Nikotinës) që karakterizohet me modifikim e ndryshim të sjelljes dhe reaksione të tjera për të marre në vazhdimësi helmin (duhan, droge) ose të paktën në mënyrë periodike deri sa të gjeje qetësi e të largohen shqetësimet e mungesës së lendes. Pra, dhe duhani me ane të Nikotinës siç është theksuar, jep efekte mendore (psikikë) shumë komplekse sa që privimi prej saj (abstenenca) çon në piken e vet kritike. Por kjo ndryshon nga individit në individ, disa mund të çlirohen lehtë nga varësia,

një shtatzënie, dhe të mos qëndrohet në ambiente ku pihet duhan.

Në France ka 14 milion duhan pirës (12 milion të rregullt), 33% meshkuj dhe 26% femra. Shqetësues është se në 17 vjeçare 4/10 (pra nder 10 vete 4 pinë duhan) dhe në 19 vjeçare kjo shifër arrin 50%. Sipas studimeve franceze duhani vret çdo vit 60 000 persona sidomos ato që pijen mbi 20 cigare në ditë, me ane të hemorragjisë cerebrale, infarktit të zemrës, bronkopneumopathi dhe kancerit fatal të mushkërive (ku shkencëtarët vënë në dukje se, po të lihej duhani kanceri i mushkërive do të zbriste me 90%, ndërsa ndotësit e tjerë ambiente të gjithë të marre së bashku mbajnë veç 10% të (të barrës) përgjegjë-



të tjerë arrijnë me vonese ose nuk arrijnë dot të çlirohen nga efektet e mungesës së këtij helmi (nikotina), kotu mendohet se ndikojnë dhe faktor trashëgues.

Disa këshilla si mund të ndërpresim pirjen e duhanit në favor të shëndetit?

Për të përcaktuar ndikimin e ndotjes nga duhan pirja tek familjaret ose tek personat rrethues ndërhyhet me një analize të quajtur Tabak-Alert, duke përcaktuar nivelin e Kotines (derivat i Nikotinës) në urine. Kjo analize ndihmon dhe grat e reja të njohin gjendjen e vet para se të fillojnë një barre, sepse duhani ndikon në zhvillimin dhe shëndetin e bebit të ardhshëm, duke u bere shkak për sëmundje të rrezikshme, por duhani ka ndikim dhe në mundësin e lindshmërisë (fertilitetit) femëror, ku sipas një studimi francez të Inserm, ku u morën në studim 1200 gra nga 18-44 vjeç së bashku me partneret e tyre -rezultoi se 50% e grave, që pinin duhan iu desh dyfishi i kohës për të mbetur shtatzëna krahasuar me jo duhanpirëset, si dhe duhani ndikonte në mënyrë negative duke dëmtuar genin e spermatozoideve "Y" (mashkullor) dhe theksohet se, çiftet duhet të lenë duhanin të paktën 3-6 muaj para se të mendojnë për fillimin e

sisë së demit shëndetësor.

Krahas masave për lënien e duhanit dhe masave shtrëngues për të mos pire duhan në ambientet publike, lokale, ambiente pune, në mjete të transportit, në pallate sporti e stadiume, kazerma, shkollë, spitale, ambulanca dhe as në shtëpi, ka rendësi dhe ushqyerja sepse largon nikotinën nga organizmi si Brokoli, spinaqi, xhenxhefil, boronica, karotat, limoni, shega, lakra (lulelakër).

Të lesh duhanin siç u shpreh, mund të kesh shenja të pa këndshme, që lidhen me zvjerdhjen (mos marrje - e helmit), duke e krahasuar me shqetësimin që ka një fëmijë, që i hiqet gjirit si: acarim nervor, depresion, ulje a shtim oreksi; probleme në përqendrim e kujtesë dhe turbullime gjumi, por në fund të fundit është e mundur të hiqet vesi i tymosjes!

Ja disa strategji, që u ndihmojnë t'ia arin objektivit të lënies duhanit sipas Allen-Carr: përcaktoni një ditë për ta lenë duhanin se një pjese e mirë pengohen nga frika se nuk do të mund ta lenë dhe kjo i pengon të mos provojnë, të lesh duhanin thajnë ato që e kanë arrit, është si të shërohesh nga një sëmundje, sepse cigarja u siguronte kënaqësi. Pra, përcaktoni një

Droga - nga aventurë - në rrezik për jetën



Lekë Imeraj -
shkrimtar, përkthyes, publicist

Shumë njerëz shtrojnë pyetjen: Përse të rinjtë konsumojnë drogë? Një pyetje e tillë është normale por, përgjigjia nuk është e lehtë.

Pjesa më e madhe e të rinjve, të moshës 12 deri në 19 vjeç, e fillojnë konsumin e drogës si kuriozitet, thjesht për ta provuar atë. Disa të tjerë e fillojnë se, edhe shokët e tyre e bëjnë këtë gjë ose, për t'u ndjerë të guximshëm. Dikush tjetër ka dëgjuar të flitet shumë për drogën dhe dëshërojnë ta provojnë vetë atë, për të vërtetuar nëse është ashtu siç flitet apo jo. Guxojnë të luajn rrolin e "lepurit eksperimental". Propaganda e konsumuesve të drogës se, droga është një mjet i besueshëm për uljen e mbingarkesës, përbalimin e konflikteve në familje dhe shkollë, menjanimin e pasiguris dhe frikës për të arthmen, është faktor i madh nxitës për konsum tek adoleshentët. Nëse dikush vuan nga ndjenja të këqia, nga dhimbjet shpirtërore, droga dhe alkoholi ndihmojnë shpejt për rikthimin në gjendje normale. Kështu e mendojnë. Shumë të rinj e marrin drogën thjeshtë dhe vetë se shikojnë të tjerët që e bëjnë këtë gjë. E mendojnë zbatimje, njohin njerëz të tjerë dhe shijojnë "kilikosjen" e nervave me sendin e ndaluar. Tek adoleshentët gjithmonë ekziston mania për të thyer "tabutë", për të përdorur të ndaluarën.

Sipas shumë psikologve, "klime" e keqe familjare, është njëri ndër shkaqet kryesor që i shtynë adoleshentët drejtë përdorimit të drogës. Sjelljet e gabuara të prindve, dhuna, injorimi dhe mospranimi i tyre nga prindët, ndëshkimet, devorcimet etj, i traumatizojnë fëmijët. Adole-

date dhe shënojeni në kalendar me rreth të kuq, po ashtu vendosni një shenje dhe cigareve deri kur të vij data, sepse duhet një përgatitje mendore (psikikë) dhe fizike, që të përgatiteni për një jete pa duhan e për shëndet më të mirë. Pra, është periudhe eksitimi, ndërkohe që jeni entuziast, duhet të ushqeheni në mënyrë të shëndetshme. Ulni yndyrat dhe përtpni diçka në goje si çamçakëz pa sheqer, karota, fare kungulli, lule dielli, fruta të freskëta, lajthi, arra. Në datën që keni caktuar, atë dite nuk do të ketë asnjë cigare në shtëpi, heq tavllat, fsheh çakmak (shkrepëse) dhe objekte të tjera, që kujtojnë vesin për të pire duhan; duke mos harruar se që sot e prapa nuk do të ndizni cigare. Pra, quajeni veten jo duhanxhi, sido që do ta dëshironit atë helm.

Tregojuni të afërmeve tuaj!

entët, nëse pajtohen me brutalitetin në familje, me jetën bosh, vetëm bardh e zi, se nuk kanë ku të shkojnë, nuk do të thotë se edhe e pranojnë atë. Jo, nuk e pranojnë. Ata vihen në rrugën e "arratisjes" dhe në rastin më të parë të mundshëm, e bëjnë këtë. Për ku? Nuk dihet. Ndoshta për tek droga.

Për pjesën më të madhe të të rinjve, droga dhe alkoholi janë një përvojë kalimtare. Sapo kanë grumbulluar në mënyrë të mjaftueshme eksperiencë të keqe dhe kanë vuajtur pasojat, ose e kuptojnë se alkoholi dhe droga nuk janë mjeti i duhur i zgjidhjes së problemeve jetike, e ndërpresin konsumimin e tyre.

Shumë të rinj e konsumojnë drogën dhe alkoholin në mbremjet rinore dhe disko pa pasur asnjë problem dhe pa menduar se mund të kalojnë në vartësi të tyre. Më së largu, kur futen në moshën e të rriturve, pjesa më e madhe e tyre, e ndërpresin vetëvetiu konsumin.

Rreziku qëndron në faktin se, gjatë



eksperimentimit, droga, mund të bëhet zakon, traditë. Atherë nuk bëhet më fjalë për zgjidhje problemesh por, për helmim kronik. Ndjenjat e këqia duhen "dehur". Kjo mendohet pika e rrezikut. Shokët drogëkonsumues, bëhen epiqendra e jetës së tyre, më të rëndësishëm se prindët, shkolla dhe e arthmja. Fillon gara midis tyre duke menduar se, ai që pi më shumë, është burrë tamam. Ekstazën e mendojnë si "varkë shpëtimi" dhe mjet për të krijuar lidhje me të tjerët. Të rinjtë që

Personat, që lenë duhanin mund të behen të stresuar (depresiv) sidomos të moshuarit, bëhen konfuz, bie kujtesa, përqendrimi preket për pak kohe, po ashtu mund të ketë shtim në peshe, prandaj duhet të parashikohen këto shenja dhe të trajtohen në kohën e duhur.

Gjeni vetveten dhe mbështetje.

Studimet tregojnë se një rrjetë mbështetje rrit shanset për të arritur objektivin, për ndërprerjen e tymosjes. Shumë qendra shëndeti ofrojnë mbështetje e programe në Veb. santeçanada; pra gjeni burime të dobishme, kjo mbështetje ju duhet sidomos 3 muajt e pare, në të cilën periudhe duhet të bëheni i durueshëm, që të mos i riktheheni këtij vesi. Hapni faqen e verdhe (page - jaune).

Preokupohuni shumë më tepër.

kalojnë në këtë fazë, nëse nuk reagojnë shpejt, rrezikohen seriozisht për të kaluar në vartësi të plotë të drogës dhe alkoholit. Atherë nuk mendojnë më as për lirinë e tyre, as për të arthmen dhe as për rrezikun. Askush nuk mund të thotë se cilët tipa janë më të predispozuar të kalojnë në vartësi të drogës dhe cilët jo.

Ka vetëm një siguri: Mospërdorimi i drogës.

Të rinjtë krijojnë një sjellje rutinë në përdorimin e drogës. E konsumojnë atë në kohë ta caktuar të ditës, në vendin e caktuar dhe me njerëz të veçantë. Ata i vëndosin vetë rregullat psh, jo drogë afër shkollës dhe në orarin e shkollës, vetëm një ditë në javë dhe i zbatojnë rregullat për aq kohë sa nuk kanë kaluar në vartësi të drogës. Kur kalojnë në vartësi, konsekuencat bëhen të dukshme: Bëhen të papërgjegjshëm, nuk ndjejnë më detyrime, fillojnë të genjejnë si drogëpërdorues dhe mendojnë vetëm për momentin tjetër në të cilin ju duhet të marrin

është planizuar. Ata dehen, edhe nëse nuk duan. Gjithnjë e më shumë, harrojnë se çfarë kanë bërë dhe çfarë kanë thënë. Për të përballuar krizat e drogës, atyre u duhet vazhdimisht të shtojnë dozën e drogës dhe alkoholit. Rëndohen me ngjarje dhe vetëm genjejnë. Braktisin shkollën, familjen, shoqërinë dhe pasionet. Bëhet të padëgjueshëm dhe brutal. Konsekuencat janë të pafund por, nuk duan t'ia dinë fare. Shumë shpejt bëhen të njohur për policinë, si shoqërisht të rrezikshëm. Fiziku i tyre pëson ndryshime negative. Dobësohen ose shtojnë në peshë.

Të gjithë drogëpërdoruesët, kanë shumë më tepër përvojë negative me drogën se pozitive dhe megjithatë, nuk e ndërpresin dot. Ata e konsumojnë atë për t'u rikthyer në gjendje normale. Problemi më i madh i tyre është gjetja e vendburimit të drogës dhe financimi dhe jo ndërprerja. Problemet me policinë i mendojnë si gjë normale. Vazhdimisht kalojnë nga substancat droguese më të lehta tek ato më të fortat. Drogat e forta si, kokaina dhe heroina, kanë fuqi më të madhe vepruese dhe e kalojnë konsumatorin në vartësi të tyre shumë më shpejt se canabisi apo alkoholi. Droga kontrollon jetën e tyre.

Problemi madhor për prindët e fëmijëve të tyre drogëpërdorues është se, çfarë duhet të bëjnë, kur e kuptojnë se, fëmija konsumon drogë?

Në raste të tilla këshilla më e mirë është: Ruani qetësinë dhe kërkoni ndihmën e kualifikuar! Duhet injoruar komplet efekti publik, pavarsisht nëse është djali apo vajza. Fjala është për një të sëmurë i cili duhet shpëtuar

dhe jo për nderin apo dinjitetin e familjes.

Çdo përdorim dhune apo ndëshkimi do të ishte me pasojë të rënda për jetën e fëmijës. Jo të gjithë në familje duhet të merren me të sëmurin por, vetëm ai që ka më tepër njohuri dhe durim. Duhet ditur se çfarë droge përdorë fëmija, sa kohë, me cilin dhe mundësisht shkaqet e përdorimit. Nëse prindi e shikon se, gjendja e fëmijës ka eskaluar, duhet t'i drejtohet menjëherë specialistit, psikologut apo socialpedagogut.

drogën. Mekanizmi i ndjenjkave bllokohet. Ata jetojnë vazhdimisht me konfliktin nëse bëjnë atë që duhet apo gabojnë duke bërë diçka të ndaluar, të rrezikshme. Megjithatë vazhdojnë konsumin dhe vazhdimisht provojnë të gjejnë justifikime të cilat, megjithëse janë fallso, i mendojnë si të vërteta.

Kur e humbin kontrollin mbi drogën, doza e përdorimit rritet, bëhet ditore, nuk njohin asnjë rregull të klikës më. Konsumojnë shumë më tepër drogë nga sa

Dihet se njerëzit kur janë të stresuar pinë shpesh duhan, po ashtu dhe në ndonjë kontekst social, sepse kur keni lenë duhanin ndjeni boshllëk, sikur ju mungon diçka, prandaj sipas vendit e momentit gjeni një aktivitet tjetër, lojëra, dëgjoni muzikë ose veni një disk që ju pëlqeni.

Shkruani elementet shpërthyes (nxitës)

Identifiko fillimisht çfarë u nxit të tentoni për të tymos (pi duhan) si: kafe, alkool e të tjera, mos merrni alkool, as kafe, merr çaj, kamomil e të tjera; përtp çamçakëz, pini ujë pa gaz, merr një frutë. Pra, ju duhet të jeni vigjilent dhe i vendosur.

Zgjidhni një ushqyerje të shëndetshme.

Eliminoni yndyrat e këqija (shtazore) dhe sheqernat e rafinuara dhe kthetuni nga frutat e perimet jeshile, për të ndi-

hmuar trupin tuaj, për të mbajtur peshën afër ideale, merrni Omega-3, Magnez, triptofan (djathë, kos) ose valeriana që u ndihmojnë të jeni të qete, zbatoni një mënyrë jete me aktive, lëvizni, përpuni të jeni të gëzuar, qeshni (u zgjatet jeta), bëni dashuri, sepse seksi rrit endorfinat natyrale (hormone të kënaqësisë); pini shumë lëngje, ujë (1.5 – 2 l në 24 ore)

Pritni 10 minuta: kur ka hall të madh për të tymosur, shikoni orën – shtyjeni për më vonë, bëhuni i vendosur, merrni fryme thelle, tre here radhazi, që të çoni ajër të freskët pa duhan: dhe ju do ta shtyni disa kohe pa tymosje. Pra, merrni vendim të forte me durim, mos iu ktheni zakonit të vjetër më kurrë.

FATIME KALIMASHI

Poete e mirënjohur në trevat e Kosovës e më gjerë, me botimet e saj. Ajo ka botuar disa vëllime me poezi: LARGËSIA MOS T'NA NDAJË, Prishtinë - 2021; VARKA E KUJTIMEVE, Prishtinë - 2020; DASHURI E MALL ETJE E PASHUAR, Rahovec - 2020; ZË I FUQISHËM FAT I STUHISHËM, Rahovec - 2020; VOYAGE Poezi në gjuhën frënge, Rahovec - 2012; MELODI E DHIMBJES, Rahovec - 2012; NË UNIVERSIN E DASHURISË, Rahovec - 2010; SHTEGËTIMET E SHPIRTIT, Rahovec - 2009;

Për punën e saj krijuese, dhe si veprimtare, është nderuar me tituj të ndryshëm nderi, si:

Me titullin "MIRËNJOHJE": FESTIVALI ANADRINIA JEHON, Kosovë - 2021; nga KLUBI LETRAR ZAHIR PAJAZITI, Kosovë - 2020; DIPLOMË - FLLADI POETIK, Tiranë - 2020; MEMBER DIPLOMA - WORLD LITERATURE ACADEMY Poezi, Londër - 2020; SH.K. A ILIRËT Ruajtjen e kultures shqiptare, Lozan 2019; "PROMENADË MËRGIMATRE" Republika e Kosovës | Prishtinë 2019

Me "ÇMIME": ÇMIMI I "SULEJMAN KRASNIQI", Rahovec - 2020; "SOLISTJA MË E DALLUAR"; ANADRINIA JEHON Muzik dhe PËR KULTIVIMIN E TRADITES MUZIKORE, POPULLORE, QYTETARE Muzik Dejnë - 2019; TITULLI "AMBASADORE E PAQES BOTËRORE "Paqe Universale, Gjenevë - 2020; CERTIFICATE OF ATTENDANCE Art and Skill, Lozan - 2019.

Ka punuar: MODERATORE NË TELEVISIONIN "SYRI TV" Solothurn, 2019 - 2021;

EDUKATORE PARASHKOLLORE SHKOLLA "IDRIZ SEFERI", RANDOBRAVË; DIPLOMË GJIMNAZI - SHOQËRORO - GJUHËSOR SHKOLLA "12 MAJI", RATKOC dhe SHKOLLA FILLORE SHKOLLA "4 Dëshmorët", RATKOC.



TI NUK PERËNDON

Edhe kur lind dielli
Gëzimi im për ty nuk perëndon
Zemra më rreh çdo çast për ty

O drita e syve të mi
Natyra ka tjetër bukuri
Asnjë çast nuk mundem pa ty

Në ty e gjeta gëzimin
I lumtur me ty jetoj
Ti më jep krah të fluturoj
Aq shumë që të dashuroj

Asnjë çast s'e dua pa ty
Zemra më ndalon
Edhe jeta bukur më kalon
Me ty afër shpirti më frymon

Sa herë të shoh në sy
Atë çast fillon zemra
Me më rreh për ty
I lumtur për ty bukuri
Rrotull si hënës të vij
E imja e bukura dashuri

Rrotull zemrës tënde
Andej të sillem çdo çast
Bukurinë tënde e përqafoj
Imagjinoj si do të ishte jeta
Jetën pa ty dot s'e imagjinoj
E me ty i lumtur jetoj

NE ...
Ne duhemi pa u takuar
Ndjehemi pa u përqaftuar
Edhe nëse kurrë nuk takohemi
Me shpirt e zemër dashurohemi

Nuk është hera e parë që flasim me ndjenja
Jo nuk do te jetë as e fundit herë
Druaj një ditë do të më lodhet zemra
Dhe lulet mund të mos çelin në pranverë

Një ditë dielli mund të mos na ngroh
As fladi i verës nuk sjell aromë trëndafilash
Jo as zëri im më nuk do të dëgjohet
Si më parë mes të ëmblit zë bilbilash

ASAJ

Ajo që dhimbjen e ndan me të gjithë
Pa dallim moshe e gjini
Ajo që zemrën ta rrëmben
Nga fjala saj me modesti

Ajo që gëzimin tënd e ndjen në shpirt
Me shpirtin e saj prej kristali
Me zemrën si bora e bardhë
Dashuri të sinqertë gjithnjë të fal

Ajo që mallin e shpreh në letër
Në çdo varg e poezi
Ajo që jeton me mallin e vjetër
Me ëndrrën e saj plot mirësi

Po kush tjetër e kupton shpirtin e saj
Që vuajtjen e kthen në lumturi
Mallin e vendlindjes e ruan në gji
Jeton me nostalgji për atdhedashuri

Asaj që shpirti iu dogj nga malli
Nuk harroi rrënjët që është shqiptare
Ajo që me trup të akullt jeton në fole
Me shpirt e zemër frymon për Atdhe

KOSOVA IME

Kosova ime plagë e vjetër
Me shekuj e vvarë
E djegur
E përgjakur
E lënduar
E përvëluar
Por kurrë e ndarë
Kosova ime plagë e hapur

Ty që shpirtin ta dorëzova
Në ty u betova
Kur u ndjeva e fortë
Shpesh të qava me lotë
Kur të thirra në emër
Kosova ime më e bukura në botë
Ti më qëndrove e fortë
Si dje ashtu edhe sot
Kosova ime plagë e paharruar

Ti nuk u dorëzove kurrë
Qëndrove e fortë si gur

Shndrite si dielli me rreze të arta
Për ty u dëgjua zëri në maje të larta
Për ty Kosova ime jetën e kemi dhënë
Për ty u betuan me babë e nënë
Për ty u flijuan motër e vëlla
Për ty u betuam kurrë mos me të nda
Kosovë plaga ime e pashëruar

Kosovë në ty që kur linda u bekova
U rrita por edhe u rrëzova
U plagosa por u shërova
Dhimbjen kurrë nuk e harrova
Para teje do të gjuhëzohem
Para armikut kurrë s'do të dorëzohem
Kosovë për ty jetoj
Deri sa të vdes për ty frymoj
Kosova ime pjesë e shpirtit tim
Vetëm në ty gjej ngushëllim

MALLIN S'E SHUAN LARGËSIA
Mbi buzët e tua ngroh buzët e mia
Prej aromës tyre i mbyllim sytë
Të përqaftuar fort për ta shuar mallin
Mallin e pashuar nga largësitë

Buzë mbi buzë si një trëndafil
Aromë e tyre dehur në shpirt
Puthemi gjatë pa i çelur sytë
Si lulet me diellin kur çelin çdo ditë

Ne puthemi se duhemi e vazhdojmë
Buzët trëndafilin dashurojnë
Kur zemrat rrahi fort nga dashuria
Dhe mallin nuk e shuan prapë largësia

FLISNI ME SHPIRT

Para se të flisni peshojeni fjalën mirë
Se fjala është më e rëndë se plumbi
Plumbi vret zemrën, por jo dhe shpirtin
Fjala vret njerëzimin fjala vret besimin

Fjala është ilaç i shpirtit kush di ta përdor
Është fashë e plagës kur gjaku pikon
Dhimbjen e zemrës largon si me dorë
Është ilaç i dhimbjes që çdo plagë shëron

Fjala e mirë ndërton jetën dhe dashurinë
Ndërton paqen miqësinë e lumturinë

Me fjalë të bukura ndërtoni ardhmërinë
Flisni me shpirt fjalë me vlera për njerëzinë

UNË DHE BORA

Ajo më zbukuron me bardhësinë
Unë e përqafoj me dashurinë
Ajo më ledhaton me bukurinë
Të dyja shkrihem me gjithë ndjesinë

Me sy i shijoj bardhësitë
Kur bëhet terr më shkëlqejnë sytë
E sa herë më buzëqesh fytyra
I buzëqeshi jetës për gjërat e mira

Ëndrrat i shikoj me dritën e hënës
Lumturinë e shoh në lartësinë e qiellit
Dielli me rreze më fal ngrohtësinë
Një botë s'më duhet pa dashurinë

Unë dashuroj diellin me rreze
Dashuroj akullin dhe borën e ftohtë
Dashuroj pikat e shiut të verës
Unë dashuroj puhizat e lehta të erës

POETI

Poeti e mban një botë më vete
Në shpirt artin e kulluar
Me duart e zemrës duke e shkruar

Poeti i ka dy botë me çudira
Një të kur bie errësira
N 'tjetër dritë i bën dëshira

Poeti sa herë vuan
Dhimbjen në shpirt kur e ruan
Si ilaç e ndjen në letër kur e shkruan

Poeti e ka jetën si dallgët e detit
Dritën e fal e pranon errësirë
Për t'i parë të tjerët më mirë

Poeti Është burim i pashterur
Frymëzohet në buzëqeshje e në lotë
Me laps e letër pasuron çdo gjë në botë

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,
Zef Gjeto, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi
Botimin:
AGUSTIN ARAMADHI

